AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:**

**"Menaxhim Risku"**

**Universiteti i Tiranës**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr.Drini SALKO**

**Prof.Dr.Besnik KRASNIQI**


**Mars /2023**

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Master i Shkencave në: "Menaxhim Risku"

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Financës |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Msc në: "Menaxhim Risku " |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Urdhër Nr. 640, datë 05.10.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës: | - |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i Dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 13.1 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 13.2 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 14 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 15 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2021 - 2022: | 13 PAE / 1 PAK<br>Ngarkesa mësimore:<br>95 % PAE / 5 % PAK |
| 16 | Numri i studentëve (2020-2022) një cikël studimi | 2020-2021 32 studentë;<br>2021-2022 27 studentë; |
| 17 | Komente / të tjera: | - |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me Vendimin Nr. 207, datë 30.05.1957 të Këshillit të Ministrave, i cili ka ofruar studime të nivelit universitar në gjashtë Institutet e tij: *Institutin Pedagogjik*, *Institutin Politeknik*, *Instituti Ekonomik*, *Instituti Mjekësor*, *Instituti Juridik* dhe *Instituti Shkencor*.

Përgjatë viteve ky institucion ka pësuar një sërë ndryshimesh, kryesisht në strukturën e tij. Në vitin 1991, nga UT (në atë kohë me 11 fakultete) u shkëputën fakultetet inxhinierike dhe u krijua Universiteti Politeknik i Tiranës. Në Janar të vitit 2013, u shkëputën dhe dy fakultete të shkencave mjekësore, për të krijuar Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. UT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, me adresë qendrore: Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, dhe në Filialin e tij në qytetin e Sarandës. Sipas strukturës aktuale, ky universitet përbëhet nga një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute si më poshtë:

- Filiali i Sarandës
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Instituti i Fizikës Bërthamore
- Instituti i Studimeve Europiane.

Universiteti i Tiranës është akredituar institucionalisht, konkretisht, me vendimin Nr. 84, datë 27.10.2018 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, është vendosur për akreditimin institucional të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti i Tiranës, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri më 26.10.2022.

Programi objekt vlerësimi Master i Shkencave në "Menaxhim Risku", është hapur sipas Urdhërit Nr. 640, datë 05.10.2018, i cili realizohet me 120 kredite në gjuhën shqipe me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Programi organizohet nga departamenti i financës, me mbështetjen e Fakultetit Ekonomik, dhe synon të ofrojë arsim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe trajnim për kërkim shkencor në fushën e financës. **Ky program studimi akreditohet për herë të parë.**

UT ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Risku", ku me shkresën Nr. 52 Prot., datë 20.01.2022 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer për qëllim akreditimi.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga Prof.Dr. Drini Salko dhe Prof.Dr.Besnik Krasniqi, i miratuar nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, mbështetur në këtë proces nga koordinatori teknik i ASCAL, Majlida Demirneli, në realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm, u mbështet në një seri dokumentesh dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standardet dhe mënyrën e funksionimit të njësive përkatëse që mbulojnë këtë program. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ dhe pasqyron situatën e procesit të formimit dhe të zhvillimit në Fakultetin e Ekonomisë, Departamentin Financës. Një rol të rëndësishëm në këtë vlerësim pati vizita në vend që u realizua pranë UT, Fakulteti i Ekonomisë në datat 27 dhe 28 Shtator 2022. Në bazë të agjendës së përgatitur paraprakisht dhe të dakordësuar me institucionin (UT, Fakultetin e Ekonomisë), u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore/bazë e struktura të tjera të këtij institucioni, ku u verifikuan dhe u shqyrtuan edhe një sërë dokumentesh të dosjes përkatëse të aplikimit për akreditim të këtij programi.

Gjatë vizitës në Institucion u realizuan takime me: Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjësin e Departamentit të Financës, Grupin e Vetëvlerësimit, stafin akademik që mbulon programin e studimit, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Kurrikulës dhe Cilësisë, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrën e Shërbimit të Studentëve, Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyrën e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Sekretarinë Mësimore. Gjithashtu, u realizua një vizitë edhe në mjediset mësimdhënëse të këtij Institucioni, sallën e kompjuterëve, bibliotekë, etj.

Në verifikimin e të dhënave u përdor metoda e marrjes së mostrës, duke nxjerrë në mënyrë të rastësishme kampionët për verifikim. Kjo metodë u përdor në verifikimin e të dhënave lidhur me cilësinë e studentëve, të dhënat e studentëve në sekretari, të dhënat për hyrje dhe dalje të studentëve në vite, lidhur me frekuentimin e leksioneve dhe të seminareve, verifikimin e praktikave të rekrutimit të stafit, etj. Së fundmi, vlerësojmë bashkëpunimin me të gjithë strukturat përkatëse të Institucionit që na mundësuan plotësimin e kërkesave tona për dokumentacion shtesë, lidhur me aspekte të caktuara në shërbim të një vlerësimi sa më objektiv.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.02.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/20 Prot, datë 02.02.2023. Universiteti i Tiranës më datë 23.02.2023, njofton nëpërmjet shkresës me nr. 3512/4 prot, datë 22.02.2023 "Mbi draft raportet e vlerësimit të jashtëm për programet e studimit master i shkencave në fakultetin e ekonomisë", komentet në lidhje me draft raportin.

*Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:*

1. **<u>Për Komentin që i përket standardit I.3, kriteri 3</u>**:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por rekomandimi jonë për këtë përmirësim të mundshëm bazohet pikërisht në specifiken qe ka ky program qe përfshin krahas riskun financiar edhe risqet e tjera. Ne kuader të hapësirës se lejuar te axhustimeve në program

rekomandimi jonë e përforcon më tej dhe e bën plotësisht unik këtë program studimi. **Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon.**

2. **Për Komentin që i përket standardit III.1, kriteri 2**:

GVJ shqyrtoi sqarimin e institucionit, por konstatimi jone bazohet në planin e ngarkesës mësimore të stafit të programit ku për disa prej tyre si rrjedhojë e angazhimit edhe në programe të tjera arrijnë këtë nivel ngarkese që ne e konsiderojmë relativisht të larte por që nuk jemi shprehur që ndikon në cilësinë e mësimdhënies. **Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon.**

3. **Për Komentin që i përket standardit III.6, kriteri 6**:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por GVJ ka evidentuar pikërisht faktin qe ne nivel institucional nuk ka program antiplagjature per tu aplikuar. Nga takimi me drejtuesit e FE te UT ne konstatuam interesin e tyre për ta përfshirë sa me shpejt gjate këtij viti përdorimin e softit antiplagjature. **Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon.**

4. **Për Komentin që i përket standardit III.6, kriteri 7**:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por praktika e deritanishme e njoftimit te studenteve për rezultatet e vlerësimit është realizuar brenda afatit 15 ditor. Nisur nga komoditeti dhe lehtësia e dhënies se këtij informacioni nëpërmjet sistemit RASH apo Pitagore, mendojmë se ky shërbim do rriste cilësinë dhe standardet në këtë drejtim. **Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon.**

5. **Për Komentin që i përket standardit IV.5, kriteri 1**:

Duke qene se ky konstatim është shprehur ne standardin III.6. kriteri 7, ky koment do te hiqet nga trajtimi ne këtë kriter. **Vlerësimi i kriterit ndryshon.**

6. **Për Komentin që i përket standardit V.2, kriteri 1**:

Duke qene se ky konstatim është shprehur ne standardin III.6. kriteri 7, ky koment do te hiqet nga trajtimi ne këtë kriter. **Vlerësimi i kriterit ndryshon.**

7. **Për Komentin që i përket standardit V.6, kriteri 4**:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por GVJ i referohet mbështetjes financiare në nivel institucional. Përsa i përket këtij programi dokordesohemi me komentin e GVB se mbështetja financiare ne kuader te projektit F-force ka qene maksimale. Mbetet konstatimi i hartimit të procedurave më të plota në funksion të këtij procesi. **Vlerësimi i kriterit ndryshon pjesërisht.**

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në: "Menaxhim Risku"**

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i studimit të ciklit të II-të Master i Shkencave në "Menaxhim Risku", ofruar nga UT/ Fakulteti i Ekonomisë, në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit. Si një program relativisht specifik dhe bashkëkohor ai i shërben përgatitjes dhe kualifikimit të studenteve në shërbim të interesave kombëtare në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik të vendit në veçanti. *Evidence nr.1.Statuti i UT* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit MSH në " Menaxhim Risku" është hartuar në zbatim të Ligjit në fuqi për Arsimin e Lartë, akteve nënligjore dhe kuadrin rregullues të tij si dhe në Strategjinë e UT-së. Ky program reflekton vlerat akademike e kulturore standarde të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky vlerësim bazohet në plotësimin e kritereve thelbësorë të këtij programi në aspektin akademik dhe atë kulturor bazuar në Statutin e UT. Parë në tërësi, programi synon përcjelljen tek studentët si të vlerave akademike, ashtu dhe të atyre kulturore në shërbim të sektorit ekonomik të vendit.<br>*Evidence nr.1.Statuti i UT*<br>*Evidenca nr.16.8.Propozim për hapjen e programit të studimit MSH në MR .* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit MSH në "Menaxhim Risku" është hartuar në mbështetje të qëllimit dhe misionit të UT-së dhe Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e tij, të shprehura në strategjinë e zhvillimit të institucionit me fokus përgatitjen e studentëve me njohuritë bashkëkohore teorike praktike në fushën e aplikimit të programeve inxhinierike dhe informatike në përgjithësi dhe të menaxhimit të riskut financiar në veçanti. Në zbatim të kësaj strategjie është edhe operimi i njësisë bazë të këtij programi, Departamentit i Financës, si pjesë e Fakultetit të Ekonomisë të UT-së. Ky program plotëson më mirë nevojat në fushën e |

| | |
|---|---|
| | veprimtarisë ekonomike të lidhura me aplikimin e programeve informatike bashkëkohore në fushën e financës.<br>*Evidence nr.1.Statuti i UT*<br>*Evidence nr.3.Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023*<br>*Evidenca nr.16.8.Propozim për hapjen e programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Ky program studimi ofron mundësi për të plotësuar tregun e punës në fushën e aplikimit në fushën e financës dhe sidomos të menaxhimit të riskut në sektorin financiar, bankar dhe sektore të tjere të ekonomise në nivel kombëtar, por para së gjithash në atë lokal. Vetë niveli i lartë i trajtimeve teoriko shkencore të menaxhim risku bën të mundur koordinimin e nivelit shkencor me atë aplikativ në shërbim të sektorit të ekonomise. Zhvillimet e viteve të fundit e kanë bere me të domosdoshme kete program studimi i fokusuar në menaxhim të risqeve.<br>*Evidence nr.14. Plani strategjik i programit MSH në MR*<br>*Evidenca nr.16.8. Propozim për hapjen e programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor | Bazuar në përmbajtjen e programit, syllabuset dhe strukturën e tij evidentojmë para së gjithash përmbushjen e standardit shkencor për një program të nivelit të dytë. Niveli dhe struktura e tij është e përshtatshme dhe përligj plotësisht përmbajtjen shkencore të programit ku dominojnë transmetimi i njohurive shkencore në fushën e ekonometrise, probabilitetit dhe modelimit në financë, të gërshetuar me ato aplikative dhe profesionale. Mbi ketë bazë programi përmbush kriteret për të mundësuar vazhdimin e programit të ciklit të tretë të studimit Doktoraturë në fushat që përfshin ky program.<br>*Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Programi i studimit MSH në " Menaxhim Risku" është hartuar në përputhje me Statutin e UT dhe rregulloret përkatëse të këtij institucioni që janë miratuar nga instancat përkatësenë vitin 2018 dhe që reflektuan ndryshimet në funksion të ligjit aktual në fuqi të arsimit të lartë. Ky program, që e ka fillesën e tij në vitin akademik 2018-2019, reflekton synimin e institucionit dhe veçanërisht njësisë bazë të tij, Departamentit të Finances, për të zhvilluar këtë program. Strategjia e institucionit që perkon po me kete periudhe (2018-2023) mëshiron edhe objektivat e këtij programi.<br>*Evidence nr.1.Statuti i UT*<br>*Evidence nr.3.Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023*<br>*Evidenca nr.14.Rregullore e programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Statuti dhe rregullorja e UT-së përcaktojnë shtyllat kryesore ku mbështetet gjithë veprimtaria akademike dhe shkencore e institucionit. Kjo rregullore është miratuar në 12.4.2010 dhe në vijimesi me vendim Senati janë miratuar amendamente të ndryshme deri në vitin 2015, duke reflektuar edhe ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Krahas kësaj baze rregullative, edhe vetë njësia bazë, Departamenti i Financës që mbulon këtë program, ka hartuar rregulloren e programit MSH në MR ku janë të përcaktuara edhe drejtimet kryesore të këtij programi.<br>*Evidence nr.1.Statuti i UT*<br>*Evidence nr.14. Rregullore e programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Ky program është në unison me fokusin dhe drejtimet kryesore akademike, shkencore dhe profesionale të Fakultetit të Ekonomisë dhe njësisë bazë të tij Departamentit të Financës, duke fokusuar problematikën e menaxhimit të riskut të financiar dhe me gjere në sektorin privat dhe publik, një drejtim ky pothuajse i pa mbuluar plotesisht nga shumica e IAL-ve në vendin tonë. Mjafton të permendim trajtimin edhe të risqeve të katastrofave, tregut të energjise, sigurise dhe shendetit në pune, fusha këto që tashme po marrin një rendesi të veçante trajtimi<br>*Evidence nr.1.Statuti i UT*<br>*Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Ky program studimi i shërben zhvillimit kombëtar dhe lokal të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, ky program studimi, nëpërmjet përgatitjes së studentëve me njohuritë teorike shkencore por edhe aplikative në fushën e menaxhimit të riskut me fokus kryesor sektorin financiar i shërben këtij zhvillimi. Kjo e bën më tërheqëse marrjen e njohurive në fushën menaxhimit të riskut të katastrofave, energjise apo shendetit në punë që po perbejnë një drejtim të rendesishem edhe për nevojat e tregut për specialist me njohuri në këto fusha. Në programin e studimit të detajuar, shohim se lëndët karakterizuese mbulojnë objektin e menaxhimit të riskut nëpërmjet programeve informatike bashkëkohore të kërkuara nga sektori financiar privat që në trendin e zhvillimit të tij rrit kërkesën për përdorimin e njohurive të menaxhimit të riskut.<br>*Evidence nr.1.Statuti i UT*<br>*Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Programi i studimit MSH në "Menaxhim Risku", ka të përcaktuara qartë objektivat e tij që përfshijnë nivelin e duhur shkencor dhe aspektin aplikativ e profesional që synon tu japë studentëve. E rëndësishme është të theksohet që për natyrën e tij pothuajse unike, ky program arrin të harmonizojë aspektin shkencor me atë aplikativ dhe profesional për të diplomuarit në këtë program. Karakterin shkencor e shohim në përmbajtjen e disa lëndëve ku dominon ana teoriko-shkencore si "Metoda Kerkimi", "Probabiliteti në Menaxhimin e Riskut", "Modelimi i Riskut në Praktike"etj, ndërsa anën aplikative e përfshijnë lëndë të tilla si: "Menaxhimi i riskut të ndermarrjes", "Menaxhimi i Riskut në Banka","Auditimi me bazë riskun", "Menaxhimi i Riskut të Katastrofave"etj. Këto janë njohuri te lidhura me |

| | |
|---|---|
| | tregun e punës me kërkesat bashkëkohore që tashmë ka sektori financiar, bankar por edhe më gjërë.<br><br>*Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br><br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Fakulteti i Ekonomisë si njësi kryesore dhe Departamenti Financës si njësi bazë e këtij programi, në fazen e realizimit të projektit K-Force kanë realizuar një studim mbi tregun e punës ku nepermjet një analize të plote të situates se programeve të studimit në universitetet partnere argumentohet rendesia e ngritjes se një programi të tille në fushen e menaxhimit të risqeve. Në vijimesi Departamenti i Financës ka organizuar edhe takime dhe intervista të thelluara me eksperte në menaxhimit të risqeve dhe ambjentit pranë institucioneve publike dhe private. Analiza e raporteve të prezantuara mbeshtetin nevojen e një programi studimi në fushen e menaxhimit të risqeve që do tu mundesoje studenteve punesime në kete drejtim.Studimi ka informacion të bollshëm dhe analiza të detajuara.<br><br>Megjithatë, në pjesën me të madhe të tij, studimi është i fokusuar në argumentin e ngritjes se një programi të tille i ngjashem me programe të tilla që zhvillohen në të gjitha vendet partnere pjese të projektit ashtu edhe në domosdoshmerinë e aplikimit të programit në Shqiperi. Nga ana tjeter objekt i një studimi tregu është edhe percaktimi i nevojes për specialiste të kësaj fushe si mundesi potenciale për punesim. Këtij qëllimi do ti shërbente edhe evidentimime i plotë i nevojave të tregut të punes me specialiste të ketij programi në sektore të ndryshem të ekonomise. Vete ngjarjet e viteve të fundit të ndodhura edhe në Shqiperi kanë treguar rritjen e risqeve financiare, të ambjentit, apo të tregjeve (ketu kemi parasysh ngjarjet lidhur me termetin, pandeminë, krizen energjitike etj që kanë dale me në pah) dhe që kerkojnë me shume specialiste të fushes së ketij programi.<br><br>*<u>GVJ rekomandon që</u>, për vetë specifikën dhe rëndësinë e këtij programi që është pothuajse unik në permbajtjen e tij, institucioni, të ndërmarrë studim të veçantë të tregut për të diplomuarit e ardhshëm në këtë program. Kjo do të mundësojë jo vetëm njohjen e drejtpërdrejtë të tregut nga institucioni, por krijon dhe lidhjen e duhur me tregun e punës e cila mund të krijojë mundësinë e marrëveshjeve mes* |

| | |
|---|---|
| | *institucionit dhe punëdhënësve potencial për të diplomuarit në këtë program. Kjo i jep UT dhe FE jo vetëm një përparësi dhe reputacion, por edhe garanci për punësim të studentëve që mbarojnë këtë program.*<br><br>*Evidence nr.15. Studim tregu*<br><br>*Evidence nr.15.1. Konsultime me fokus grup dhe eksperte* |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Nga shqyrtimi i programit të studimit, konstatohet që në tërësinë e vet ky program bazohet në objektiva formuese të qarta dhe strukturë të përshtatshme që janë në funksion të dijeve dhe aftësive të studentëve në tregun e punës. Ky program tashmë i përgatitur në kuadër të kërkesave ligjore dhe rregullative me kohëzgjatje 2 vite akademike, arrin ti përgjigjet nevojave të tregut të punës sidomos në sektorin financiar privat dhe publik me specialistë që kanë njohuri të avancuara teoriko shkencore, në kuadër të menaxhimit të riskut, duke përbërë një premisë për të pasur kërkesa të shumta nga ky treg. Vetë përmbajtja e programit, që është pothuaj unik në atë çfarë specialistë përgatit, përbën përparësi të institucionit që e ofron. Një përparësi tjetër që mendojmë është se ai është atraktiv për gjithe studentët që kanë mbaruar programin Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës,<br><br>*Duke parë më me detaje programin i cili perfshin menaxhimin e riskut pertej fokusit tradicional që kanë programe të tilla pranë institucioneve të tjera të arsimit të larte në Shqiperi, mendojme se në kuadër të hapësirës së lejuar për ndryshime në kurrikul në këtë fazë do ta rekomandonin futjen e një moduli të menaxhimit të riskut mjedisor drejtim ky që po perben prioritet studimi sot dhe që rrit me tej mundesite e punësimit.*<br><br>*Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br><br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucioNë ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e | Nga shqyrtimi i këtij programi studimi mendojmë se ai përafrohet plotesisht me programe të ngjashme studimi në Universitete homologe të vendeve të tjera që fokusohen në fushën e menaxhimit të riskut. Nga vizita në institucion,morëm informacion për referencën e përgatitjes së këtij programi me universitete të huaja që ofronin programe në këtë fushë dhe që UT ka marrëveshje, si dhe të faktit të ngritjes se ketij programi si output i projektit K- |

| | |
|---|---|
| studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | Force ku partner të projektit janë universitete të huaja të mirenjohura.<br><br>*Evidence nr.3.Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023*<br><br>*Evidenca nr.14.Rregullore e programit të studimit MSH në MR Evidence nr.15. Studim tregu* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | Ky program studimi është hartuar bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Hartimi është fokusuar në cilësinë e mësimdhënies, në zhvillimin e tij kryesisht me staf efektiv dhe vazhdimësinë e programit me të gjitha ndryshimet në të. Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulën e programit MSH në "Menaxhim Risku" në variantet me 120 ECTS, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira bashkëkohore.<br><br>*Evidenca nr.14.Rregullore e programit të studimit MSH në MR Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br><br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e menaxhimit të riskut, duke synuar që të rrisë edhe aftësitë praktike që përfshijnë fushën e mësipërme. Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të këtë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin që mbulon këtë program, u theksua rëndësia që i jepet gjatë zhvillimit të shumicës së lëndëve karakteri aplikativ nëpërmjet programeve bashkëkohore dhe që janë tashmë prezentë në shumicën e institucioneve financiare në vend. Nga verifikimi ynë, praktika profesionale realizohet kryesisht pranë institucioneve financiare apo kompanive në degët e financës së tyre.<br><br>Bazuar në emërtimin e programit, ky program është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Emërtimi i programit është në përputhje me drejtimin e tij në Menaxhim Risku në sektorin financiar dhe me gjerë.<br><br>*Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br><br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Në programin e studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit. | Megjithe që programi ofrohet në gjuhen shqipe, stafi akademik i angazhuar në këtë program zotëron gjuhë të huaja të vendeve të BE dhe mund të zhvillojë leksione në këto gjuhë. Nga vizita pranë institucionit, takimin me stafin që mbulon programin si dhe shqyrtimi i CV të stafit, evidentuam këtë fakt, aq më teper që pedagoge që zhvillojnë lënde të caktuara kanë mbaruar studime jashte vendit apo kanë dhenë leksione në to në kuader të staff mobility të projekteve ERASMUS +. Nisur nga fakti që kemi të bëjmë me një program MSH që është i detyrueshëm zotërimi i gjuhës së huaj për studentët, kjo nuk përben pengesë por përparësi pasi keta të fundit e kanë të çertifikuar zoterimin e gjuhes se huaj sipas kerkesave ligjore. Në kuader të angazhimit të zhvillimit të leksioneve të hapura , janë zhvilluar të tilla në gjuhen angleze. Gjithashtu, në këto lëndë, por jo vetëm, si literaturë rekomanduese jepet në anglisht. Dhënia e lëndëve të veçanta në gjuhë të huaj, jep mundësinë në të ardhmen e realizimit të mobiliteteve nga studentë të universiteteve të huaja pranë institucionit në kuadër të programeve të ndryshme ERASMUS, etj.<br><br>*Evidence 16.8. Propozim për hapjen e programit MSH në MR*<br><br>*Evidenca nr.24. leksione të hapura* |
| **Kriteri 8.** Për programin studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze | Pranë institucionit ruhen dhe arkivohen në gjuhën angleze një pjesë e dokumentacionit të lidhur me programin si: programi i studimit, syllabuset, CV e personelit, marrëveshjet e bashkëpunimit, rregullore të brendshme, etj. Ky informacion ruhet në formë elektronike dhe hardcopy. Ruajtja e dokumentacionit respekton dhe konfidencialitetin e tyre, që është sanksionuar në rregulloret e institucionit.<br><br>*Evidence nr.4. Rregullore e brendeshme e punes se UT*<br><br>*Evidence nr.48. Manuali i arkives* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.4** |
|---|
| **Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** |

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| --- | --- |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Organizimi i UT, struktura e tij hierarkike është e ndërtuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin dhe objektivat e përcaktuara prej tij por edhe të programit MSH në "Menaxhim Risku", duke pasur edhe përvojën, kapacitetet dhe burimet njerëzore të përshtatshme për një mision të tillë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës që mbulon këtë program studimi, arrijnë që nëpërmjet kualifikimit të nevojshëm dhe kapaciteteve akademike që ato kanë, të realizojnë me sukses zhvillimin e programit. Kështu, bazuar në organigramën e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore e programit, ai përfshin gjashte Departamente me një personel akademik efektiv ((PAE) prej 172 punonjesish dhe që perfaqeson Fakultetin Ekonomik me të hershem dhe me të madh në vend.<br>*Evidence nr.16.7. CV e stafit akademik të programit*<br>*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela 1)* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi MSH në: Menaxhim Risku funksionon në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është relativisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program studimi që është Fakulteti i Ekonomisë si një ndër Fakultetet e UT.<br>*Ligji Nr. 80/2015;*<br>*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje | Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi që është Departamenti i Financës mbulon këtë program, i cili që në emërtim është i njëjtë me objektivin e këtij programi dhe që gjithashtu ka pjesën me të madhe të stafit të programit nga fusha e financës.<br>*Evidence nr.20.3. Analiza vjetore e Departamentit të Financës për vitin 2020-2021.*<br>*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [redacted] | [redacted] | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi I.5 | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Njësia bazë mësimore shkencore e realizimit të këtij programi është Departamenti i Financës. Departamenti operon në dinamikën e tij duke zhvilluar takime dhe diskutime periodike për problematikën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, etj. Ndër funksionet kryesore të Departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve) si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies.<br><br>Përgjegjësitë e kësaj njësie bazë si dhe të hallkave të tjera të Fakultetit janë të mirë përcaktuara në rregulloret përkatëse të institucionit dhe në rregulloren e Fakultetit. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për vlerësimin e performancës së personelit akademik të Departamentit gjatë vitit akademik. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe veprimtarinë e tij shkencore.Vlerësimet e mësipërme u evidentuan edhe gjatë vizitës në institucion.<br><br>*Evidence nr.2. Rregullore e UT*<br><br>*Evidence nr.20.3. Analiza vjetore e Departamentit të Financës për vitin 2020-2021.* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, | Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se UT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh me |

| | |
|---|---|
| institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe brenda vendit, si dhe me një numër institucionesh dhe subjektesh ekonomike shteterore dhe private. Keto marreveshje bashkepunimi janë realizuar kryesisht nepermjet projekteve të perbashketa si Tempus, ERASMUS + ; IPA etj. Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime reciproke të vizitave akademike shkencore si dhe marrëdhënie të tjera reciproke në fushën e kualifikimit, shkëmbimit të eksperiencave, realizimit të praktikave mësimore etj. Edhe vete ngritja e ketij programi studimi është realizuar në kuader të projektit nderkombetar Ndertimi i Kapaciteteve në Edukimin e Larte (Capacity Building in Higher Education) K-Force. Gjatë vizitës në institucion u evidentua edhe përfshirja e lektorëve të huaj për të dhënë leksione për tema të veçanta, ku një temë specifike është trajtuar me studentët e këtij programi dhe të programeve të tjera në fushën e ekonomisë<br><br>*Evidence nr.21 dhe 21.1. Lista e marreveshjeve të bashkepunimit në nivel FE të UT*<br><br>*Evidence nr.25 dhe 25.1. Lista e partnerve në kuader të projektit K-Force* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Nga shqyrtimi i dosjes së përcjellë dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se UT ka një sërë marrëveshjesh me institucione dhe sipërmarrje në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Gjatë takimeve në FEUT, pedagogët u shprehën, por dhe studentët konfirmuan që pedagogët konribuojnë në punësimin apo intershipet e tyre, përmes ndarjes së informacionit në auditor dhe mbështetjes në karrieren të tyre. *Evidence nr.21 dhe 21.1. Lista e marreveshjeve të bashkepunimit në nivel FE të UT* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron. | Në realizimin e praktikës profesionale hartohet kontratë e përbashkët mes FE të UT dhe entit përkatës në funksion, kjo edhe të natyrës së programit studimor. U verifikua që institucioni ka të miratuar nga Dekani paketën e plotë të praktikës me të cilën paisen studentët e këtij programi. Kjo u konfirmua dhe nga takimi me studentët. Paketa përfshin proceduren e ketij procesi, programin e praktikës, vlerësimin e monitoruesit të saj, hartimin e një raporti nga studenti për praktiken e realizuar etj, në funksion edhe të realizimit të praktikes profesionale institucioni UT apo FE i UT ka 37 marreveshje bashkepunimi me institucione apo ente të |

| | |
|---|---|
| | ndryshme në vend me afate të caktuara apo edhe të pacaktuara mes paleve .<br><br>*Evidence nr 17. Paketa e praktikes profesionale*<br><br>*Evidence nr.21 dhe 21.1. Lista e marreveshjeve të bashkepunimit në nivel FE të UT* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton bashkëpunim me institucioNë homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it institucioni ka një numer marreveshje bashkepunimi me institucione homologe të huaja të realizuara apo edhe në proces. Në kuader të projektit K-Force dhe projekteve ERASMUS + janë neneshkruar marreveshe bashkepunimi me universitete partnere, gje që ka mundur të siguroje mobilitete për stafin dhe studentet e ketij programi. (si: University of Vallodolit, Spanj, University of Poitiers, France, University of Staffordshire UK, University of Novi Saf; University of Tuzlaa, etj). Nga takimi me studentët u evidentua angazhimi i tyre në kërkim shkencor lidhur me përgatitjen e punimit të mikrotezës bazuar edhe në leksionet e hapura të organizuar nga lektore të huaj në kuader të ketyre projekteve .<br><br>*Evidence nr.25.1. Marreveshjet nderinstitucionale në kuader të projektit K-Force*<br><br>*Evidence nr. 27.1. Lista e mobiliteteve të stafit akademik*<br><br>*Linku referuar projekteve nderkombetare ku UT është partnere* |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | Departamenti i Financës nuk harton raporte të veçanta lidhur me bashkëpunimin me entet e ndryshme. GVJ shqyrtoi raportet periodike të analizës mësimore shkencore të Departamentit, ku në to përfshihet edhe analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me entet e ndryshme. Në kuader të projektit K-Force është hartuar edhe raporti i ecurise se ketij projekti.<br><br>*Evidence nr.20.3.Analiza vjetore e Deopartamentit të Financës 2020-2021* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.6**<br><br>**Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | Konstatohet se UT synon të jetë aktiv në fushën e kërkimit shkencor të personelit akademik nepermjet nxitjes dhe mbeshtetjes se ketij procesi e theksuar kjo edhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit 2018-2023. Në webin e institucionit u evidentuan si thirrjet e hapura për projekte ashtu edhe projektet kombetare fituese të kerkimit dhe zhvillimit "Horizon" apo ERASMUIS +. Vete institucioni në kuader të programit "UT -kerkim ekselence, inovacion" ka mbeshtetur financiarisht nisma të stafit për publikimet e bëra nga personeli akademik si dhe veprimtari të tjera lidhur me kërkimet shkencore.<br><br>*Evidenca nr.3. Startegjia e zhvillimit të UT 2018-2023*<br><br>*Evidence nr.26. Thirrje për projekte në kuader të programit të UT"kerkim, ekselence , inovacion"*<br><br>*Linku referuar projekteve nderkombetare ku UT është partnere* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Institucioni nuk ka njësi të veçantë për kërkimin shkencor por ky proces është pjese e Komisionit të Perhershem të Sigurimit të Standardit të cilësisë i percaktuar në Statut si dhe të NJBSC të ngritura në nivel institucional dhe njësisë kryesore se fundmi. Në nivel të njësisë kryesore (FE i UT) kerkimi shkencor ndiqet nga një nga Zv.Dekanet si dhe NJSBC të FE si pjese e funksioneve që kjo njesi ka. Departamenti i Financës si njesia bazë qe mbulon kete program ndjek dhe analizon periodikisht (në analizat vjetore) punen kerkimore shkencore të stafit të saj. Gjithashtu, ndjekja e procesit kërkimor shkencor bëhet nga Zv.Dekani për kërkimin shkencor. Evidentimi i punes kerkimore shkencore të stafit akademik realizohet nepermjet raportimit të tyre vjetor, gje që dokumentohet si pjese e dosjeve individuale të tyre.<br><br>*Evidencenr.1.Statuti i UT*<br><br>*Evidence nr.19, 2 dhe 3. Raport i kerkimit shkencor të FE të UT në periudhen 2019-2020;2020-2021*<br><br>*Evidence nr.20.3. Analiza vjetore e Departamentit të Financës për vitin 2020-2021.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | Personeli akademik, krahas punës së pavarur kërkimore shkencore, promovohet nëpërmjet përfshirjes në projektet kërkimore të fituara nga institucioni, duke bërë të mundur publikimin e tyre dhe në disa raste mbështetjen financiare. Punime shkencore të personelit akademik janë botuar në revistat shkencore të Fakulteteve të UT. Njesia kryesore që mbulon kete program FE i UT boton revesten e tij " Ekonomia dhe Biznesi" me Bord Shkencor si dhe janë promovuar botime në revista të huaja me faktor impakti.<br><br>*Evidencenr.1.Statuti i UT*<br><br>*Evidence nr.8.rregullore"Per ushtrimin e veprimtarise të promovimit të personelit akademik"*<br><br>*Evidence nr.19, 2 dhe 3. Raport i kerkimit shkencor të FE të UT në periudhen 2019-2020;2020-2021*<br><br>*Evidence nr.20.3. Analiza vjetore e Departamentit të Financës për vitin 2020-2021.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese. | Kopje të punimeve shkencore janë të arkivuara në bibliotekën e UT dhe në dosjet përkatëse të personelit, të cilat u panë në mënyrë të rastësishme edhe gjatë vizitës në institucion. Në botimet e publikuara në revistat e njesive kryesore të UT theksohet pronësia intelektuale e tyre me qellim minimizimin e plagjiaturave.<br><br>*GVJ sugjeron se UT duhet të pershpejtoje blerjen e software perkates për kontrollin e plagjatures i planifikuar në buxhetin e vitit 2021*<br><br>*Evidence nr.5.Kodi i etikes i UT*<br><br>*Evidence 37. Buxheti i miratuar për vitet 2019, 2020 dhe 2021* |
| **Kriteri 5.** Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor | Institucioni ka angazhuar studentë në projektet ku është partnere si dhe në ndihmë të kërkimeve shkencore që realizon personeli akademik sidomos në anketime dhe përpunim të dhënash. Shpesh kjo punë e tyre materializohet në punimin e mikrotezes. Bashkepunimi në punë shkencore të studeteve ka bere që të botohen në revisten e FE të UT artikuj të perbashkët pedagog student. Po ashtu në konferenca kombetare dhe nderkombetare të organizuara nga FE i UT apo vete Departamenti i Financës të kemi pjesemarrje të studenteve të programeve mesimore të ciklit të dyrte dhe të trete.<br><br>*Evidence nr.23.1. Konference në kuader të projektit K-Force* |

| | |
|---|---|
| | *Evidence nr.23.2.Konference e organizuar nga Departamenti i Finances*<br>*Evidence nr.23.3. Kobnference e organizuar nga Fei UT.*<br>*Evidence nr,23.4. Konferenca studentore të Fe të UT* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit MSH në "Menaxhim Risku" i liçencuar me urdher të Ministrise se Arsimit Sporteve dhe Rinise nr.640 date 05.10.2018 është bazuar në plotësimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në fuqi si dhe në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"*, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë, me një total 120 kredite në dy vitet dhe me ngarkesë studenti 25 orë në javë. Duke shqyrtuar planin mësimor të këtij programi studimi, konstatohet që secila nga 15 lëndët e përfshira në program, është vlerësuar me 6 kredite. GVJ mendon që bazuar në metodologjinë e përcaktimit të krediteve për lëndët e veçanta si dhe në mjaft eksperienca të programeve në universitete të tjera, numri i krediteve të përcaktuara, duhet të luhatet në funksion të ngarkesës (angazhimit) në auditor dhe jashtë tij të studentit qe mund të ndryshojnë për lende të veçanta. |

| | |
|---|---|
| | *Në këtë gjykim, sugjerohet që lëndë të caktuara karakterizuese mund të kenë një numër kreditesh me të lartë se të tjerat, kjo rrjedhojë e vështirësive apo orëve të angazhimit jashtë auditorit per studentët, që për lëndë të ndryshme mund të jenë më shumë apo më pak.*<br><br>*Evidenca nr.16, Dosja e programit të studimit*<br>*Evidenca Nr.16.1. Vendimi i liçencimit të programit*<br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022*<br>*Evidence.nr. 40. Tabelat permbledhese e RVB ( tabela 4 )* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Nga shqyrtimi i programit mësimor si dhe përmbajtjes së syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës, aplikimit praktik të programeve financiare dhe ekonometrike. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë të riskut, në fushen e Financës pranë institucioneve financiare apo sipermarjeve private si dhe në sektorin publik të analizes ekonomike. Trajtimi në kete program të menaxhimit të risqeve në fusha të veçanta si risku i katastrofes, të sistemeve të informacionit apo ate klimaterik e bejnë kete program jo vetem me të plote dhe bashkekohor por dhe unik krahasuar me teresinë e programeve të menaxhimit të riskut që zhvillohen në vendin tonë nga institucionet e tjera të Arsimit të Lartë.<br><br>*Evidenca nr.16, Dosja e programit të studimit*<br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit. Nga shqyrtimi i syllabuseve vihet re që ka tema të cilat japin një trajtim të shpejtë të koncepteve të marra në programin Bachelor sipas fushës që mbulon lënda përkatëse. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës apo ekonomisë. Nga ana tjetër, lëndë karakterizuese të programit si grup ledet e menaxhimit të riskut apo lendet e "Ekonomotrise" apo "Metoda kërkimi", etj., japin mjaft trajtime teorike të avancuara ku përfshihen edhe ndërthurjet e njohurive të informatikës me ato të financës apo ekonomisë në tërësi. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi i studimit ofron njohuri të avancuara në fushën teorike shkencore, por dhe të natyrës aplikative në fushën specifike të të menaxhimit të riskut. Këtij qëllimi i shërbejnë trajtimet specifike të menaxhimit të riskut në sektoret real dhe financiar të ekonomisë. Ketu perfshihen njohurite bashkekohore të menaxhimit të rikut në sektorin financiar e bankar, sektorin publik dhe tregjeve të sigurimit të energjise etj. të cilat gërshetohen me njohuritë e modelimit të riskut në praktike.<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Nga shqyrtimi i këtij programi studimi rezulton se ai përfshin të gjithë elementët strukturor të përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullative që kanë objekt arsimin e lartë në Shqipëri, të tilla si numri i krediteve, kohëzgjatja e tij, sistemi i vlerësimit me kredite, kategorizimi i lëndëve, praktika profesionale, finalizimi i perfundimit të programit nepermjet mbrojtjes me një punim mikroteze etj.<br><br>*Evidenca nr.16.3. Rregullore e programit MSH në Menaxhim Risku*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit ofrohet me 120 ETCS *(ku përfshihen 15 lëndë, praktika dhe detyrimet përmbyllëse me mbrojtjen e punimit të mikrotezes)* dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike. Bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, sipas kategorizimit të lëndëve të paraqitura në programin e studimit rezulton se:<br><br>Lëndët e kategorisë A zënë 10 % të numrit të krediteve;<br><br>Lëndët e kategorisë B zënë 50 %;<br><br>Lëndët e kategorisë C zënë 15 %;<br><br>Lëndët e kategorisë D zënë 10 %;<br><br>Lëndët e kategorisë E zënë 15 %;<br><br>Bazuar në kriteret e miratuara për një program MSH shohim se struktura e programit permbush kriteret e vendosura.<br><br>*Evidenca nr.16, Dosja e programit të studimit*<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit* |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për | Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën për përgatitjen e punimit të mikrotezës me 18 kredite me të cilën studenti |

| | |
|---|---|
| realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj | përmbyll këtë program duke marre diplomën "Master i Shkencave" në "Menaxhim Risku" sipas modelit të percaktuar e neneshkruar nga titullari i njësisë kryesore dhe titullari i instituionit. *Evidenca nr.16, Dosja e programit të studimit* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br><br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | UT, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave si Institucion i Arsimit të Lartë Publik, është i organizuar dhe i përbërë me një strukturë hierarkike të tillë që të përmbushë dhe objektivat e programit MSH në " Menaxhim Risku". Fakulteti i Ekonomisë,( si një nga 7 fakultetet e UT) si njësia kryesore e ketij programi me një historik tashme prej rreth 65 vitesh perfshin 6 njesi bazë ku Departamenti i Financës si një prej tyre është pergjegjes i zhvillimit të ketij programi duke permbushur plotesisht kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022.<br><br>*Evidenca nr.3. Strategjia e zhvillimit të UT*<br><br>*Evidenca nr.16, Dosja e programit të studimit*<br><br>*Evidenca nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB( nr.1)* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Fakulteti i Ekonomisë, si njësia kryesore (një nga 7 Fakultetet e Institucionit) dhe Departamenti Financës si njësi bazë që mbulon zhvillimin e këtij programi, përmbushin kriteret ligjore dhe aktet nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Ekonomisë, plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ka në përbërje njësitë bazë: |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore | **1.** Departamenti i Ekonomiksit;<br>**2.** **Departamenti i Financës;**<br>**3.** Departamenti i Kontabilitetit;<br>**4.** Departamenti i Marketing Turizmit; |

| | |
|---|---|
| për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.<br><br>**Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | **5.** Departamenti i Menaxhimit;<br>**6.** Departamenti i Statistikë Informatikë e Zbatuar;<br><br>Fakulteti i Ekonomisë në vitin akademik 2021-2022 është i përberë nga 464 Personel Akademik gjithsej, nga ku 175 Personel Akademik Efektiv (PAE), dhe 289 Personel Akademik me Kontratë (PAK),të cilët kanë kualifikimin si më poshtë |

| Fakulteti i Ekonomisë | PAE | PAK |
|---|---|---|
| Prof. Dr. | 25 | 12 |
| Prof. As. Dr. | 40 | 6 |
| Dr. / PhD. | 61 | 58 |
| MSc. | 49 | 213 |
| **Totali** | **175** | **289** |
| | **464** | |

Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezulton se çdo njësi bazë e FE plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor.

Departamenti i Financës si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2021-2022 ka këtë paraqitje:

| Kualifikimi i stafit | **Departamenti i Financës** | |
|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** |
| Prof.Dr | **2** | 2 |
| Prof.Asoc | 8 | 3 |
| Dr/PhD | **12** | 6 |
| Msc | 7 | 41 |
| **Gjithsej** | **29** | **52** |

Numri i PAK është 52. të cilet mbulojnë rreth 24.8 % të ngarkeses mesimore në Departament kundrejt 75.2 % që mbulon stafi efektiv i Departamentit.

Lidhur me zhvillimin e procesit mesimor shkencor të ketij programi,

- Në vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 16 antare staf akademik nga të cilet 11 antare apo 69 % e numrit total janë PAE dhe 31 % apo 5 antare janë PAK,

| | |
|---|---|
| | • Në vitin akademik 2020-202 janë angazhuar 14 antare staf akademik nga të cilet 12 antare apo 86 % e numrit total janë PAE dhe 14 % apo 2 antare janë PAK,<br>• Në vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar 14 antare staf akademik nga të cilet 13 antare apo 93 % e numrit total janë PAE dhe vetem 7 % apo 1 antare janë PAK.<br><br>Shohim se kemi një ecuri pozitive të zhvillimit të ketij programi kryesisht me PAE.<br><br>*Evidenca 40. Përmbledhëse e tabelave të RVB*<br><br>*Evidenca nr.1. Statuti i UT*<br><br>*Evidence nr.40.Tabelat permbledhese te RVB*<br><br>*Evidenca 40. Përmbledhëse e tabelave të RVB* |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit nga institucioni si dhe nga takimet e realizuara gjate vizites në institution Departamenti angazhon personel akademik për të ndjekur ecurinë e zhvillimit të praktikave të studenteve në semestrin e kater të programit. Gjithashtu personeli ndihmes që është në strukturen e Departamentit angazhohet në zhvillimin korrekt të mesimeve laboratorike dhe dorezimin e projekteve nga studentet e programit.<br><br>*Evidenca 40. Përmbledhëse e tabelave të RVB*<br><br>*Vizita në institution në takim me stafin dhe studentet.* |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Nga shqyrtimi i rregullores së Fakultetit të Ekonomisë dhe rregullores së këtij programi janë të përcaktuara qartë gjithë problematikat lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor-shkencor. Nga vizita në institucion evidentuam që Përgjegjësi i Departamentit Financësë monitoron edhe këtë program duke qenë njëkohësisht edhe koordinator i këtij programit dhe hartues i raportit për kete program<br><br>*Evidenca nr.16.2 Vendimi i caktimit të koordinatorit të programit*<br><br>*Evidenca 20.4. Raporti i kordinatorit të programit* |
| **Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike të drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit | Kordinatori i programit ndjek në vazhdimesi ecurinë e tij që në fazen e regjistrimit të kandidateve, ecurin e procesit mesimor shkencor, problematiken e dale, duke hartuar dhe një raport të veçante me fokus zhvillimin dhe ecurin e tij gjate tre viteve që ky program është funksional. *Evidenca 20.4. Raporti i kordinatorit të programit* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga institucioni, Fakulteti i Ekonomisë si njesi kryesore dhe Departamenti Financës si njesi bazë e programit, dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe që janë të arshivuara por edhe të shpallura edhe në website e ketyre njesive<br>*Evidenca nr.16.Dosja e e programit të studimit dhe verifikim gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë: |

| **Kategoria /** | **Përqindja Krediteve Sipas VKM** | **Programi Msc. MR** | |
|---|---|---|---|
| | | **Kredite** | **Përqindje** |
| A. LËNDË BAZË | 5%-10% | 12 | 10% |
| B. LËNDË KARAKTERIZUESE | 50%- 60% | 60 | 50% |
| C. LËNDË NDËRDISIPLINORE | 12%-20% | 18 | 15% |
| D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika) | 10% | 12 | 10% |
| E. DETYRIME PËRMBYLLËSE | 10%- 15% | 18 | 15% |

*Evidenca nr.16. Dosja e e programit të studimit*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Programi përfshin një numër total prej 120 ECTS dhe është i ndarë në strukturë në orë në auditor, orë në aktivitete të tjera si projekte, orë studimi individual, elementë këto matës të sistemit ECTS. Oret në auditor (1210 ore) dhe oret jashte auditorot (1790 ore) janë ndarë në mënyrë të barabartë në katër semestrat e vitit akademik. *Evidenca nr.16.Dosja e e programit të studimit* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Në programin mesimor jepen shume qarte informacionet që kanë të bejnë me ngarkese mesimore vleresimin e njohurive metodat e mesismdhenies, kriteret mbi frekuentimin dhe realizimin e praktikes etj. Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht, ku çdo student sheh programin e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.<br><br>*Evidenca nr.16, Dosja e programit të studimit*<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 5.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Marrja e informacionit për kriteret dhe procesin për tu regjistruar në këtë program si dhe për studentet që po e zhvillojnë kete program si dhe mundesia e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve realizohet nëpërmjet:<br><br>• Rregullores së studimeve të UT;<br>• Rregullores së Fakultetit të Ekonomisë;<br>• Rregullores së programit MSH në "Menaxhim Risku";<br><br>*Evidenca nr.13.Broshura e Departamentit të Finances*<br><br>*Evidenca nr.16.3. Rregullore e programit MSH në Menaxhim Risku* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit MSH. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërejmë se ato përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :<br><br>• Emërtimi i lëndës/modulit<br>• Viti/semestri kur zhvillohet lënda<br>• Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën<br>• Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit<br>• Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetimin e lëndës |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">

- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuara në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e vleresimit të mësimnxënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatësisht, studenti vlerësohet në kufijte 40% deri 50 % nga elementet gjate vitit dhe 50% deri 60% nga provimi përfundimtar.

*Evidenca nr.16.5.Programet Mesimore të lendeve 2020-2021*

*Evidenca nr.16.6. Programet Mesimore të lendeve 2021-2022*

*Verifikim nga procesverbalet në sekretari.*

</td></tr>
<tr><td>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</td><td colspan="4">

Ky program ka tre vite që zhvillohet dhe titullaret e lendeve dorezojnë në çdo fillim viti programin e lendes. Nga takimi me stafin rezulton se në programe reflektohen perditesimet sidomos lidhur me literature bashkekohore.

*Evidenca nr.16.5.Programet Mesimore të lendeve 2020-2021*

*Evidenca nr.16.6. Programet Mesimore të lendeve 2021-2022*

*Takimi me stafin që zhvillon kete program.*

</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>[illegible]</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Web site:

| **Standardi II.4**<br><br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit "Master i Shkencave"/"Master i Arteve" është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Ky program studimi plotëson kërkesat ligjore (neni 75, pika 6 e Ligjit të Arsimit të Larte dhe kerkimit shkencor në RSH, nr.80/2015) dhe nënligjore në fuqi. Ai realizohet me një ngarkesë mësimore, shkencore dhe praktike me 120 ECTS dhe me afat kohor dy vite akademike. Në program perfshihen një ngarkese prej 1210 ore mesimore në auditor dhe 1790 ore mesimore jashte auditorit. Shperndarja e kesaj ngarkese është uniforme në të kater semestrat perkates. *Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit* |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Nga shqyrtimi i programit shohim që në përmbajtjen e tij ai ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë në fushën e Menaxhimit të Riskut. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës kryesisht të sektorit financiar e bankar. Në program dominojnë lendet e fokusuar në objektin e tij që është menaxhimi i riskut në fusha apo sektore të ndryshëm të ekonomise.<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.5.Programet Mesimore të lendeve 2020-2021*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet Mesimore të lendeve 2021-2022*<br><br>*Takimi me stafin që zhvillon kete program.* |
| **Kriteri 3.** Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Programi arrin të pajisë studentët krahas njohurive të përgjithshme dhe specifike në fushën e riskut dhe menaxhimin e tij edhe mundesinë për të realizuar kerkime shkecore  në sektore të veçante të cilat ballafaqohen me natyra të ndrsyhme të riskut. Nga ana tjeter, programi arrin të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e analizes dhe modelimit të riskut. |

| | |
|---|---|
| | Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektivi në rritjen më shumë të përgatitjes profesionale të studentëve. *Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit* |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punëspër specialiste në menaxhimin e riskut. Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me drejtimin e zgjedhur që është menaxhimi i riskut në sektoret real dhe financiar e bankar. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. në kuader edhe të projektit të perbashket në hartimin e ketij programi është bashkepunuar edhe me universitetet analoge të disa prej vendeve të BE. Propozimi për hapjen e ketij programi studimi është bazuar edhe në një studim tregu me operatoret kryesor të tij nepermjet intervistave dhe pyetesoreve të fokusuar në objektin e programit.<br><br>*Evidenca nr.15.Studimi i tregut*<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.8. Propozim perhapjen e programit të studimit*<br><br>*Evidenca 20.4.2: Raportim mbi mbarevajtjen e projektit K-force në rektorat.* |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Duke analizuar planin mesimor dhe programin mesimor të prezantuar në aplikimin e institucionit si dhe nga bashkepisedimi me stafin që mbulon kete program verejme se ka një raport të drejte mes formimit teorik dhe atij praktik të studenteve që kanë preferuar të jenë menaxhere të riskut në sektoret real dhe financiar. Pa dashur të perserisim strukturen e programit të trajtuar me lart shohim që ka harmonizim të trajtimeve teorike në lendet e formimit të |

| | |
|---|---|
| | pergjithshem me grupin dominues të lendeve të formimit professional. Nga shqyrtimi i programeve të lendeve shokojme se në to kemi si trajtime teorike të avancuuara ashtu edhe aplikime të metodave të drejtimit të riskut. Trajtimi i rasteve studuimore, puneve laboratorike dhe realizimit të praktikes mesimore harmonizon realizimin e objektivave të ketij program.<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 6.** Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Nga shqyrtimi i programeve të lendeve si dhe nga takimi me stafin në instituion evidentohet permbajtja cilesore e të gjithe elementeve të percaktuar. Edhe pse ky program ka vetem 3 vite që po zhvillohet ka plotesime apo axhustime në programe të disa lendeve me qellim permiresimin e tyre por edhe si reflektim i zhvillimeve të fundit. Keshtu në kuader të efekteve të ngjarjeve madhore apo të tregut janë axhustuar lende të tilla si , "Menaxhimi i Riskut të Katastrofes" apo "Tregjet e Energjise".<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022*<br><br>*Takim me stafin që mbulon programin* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë. | Programi MSH në " Menaxhim Risku" i pajis studentët që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë dhe financës, me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike të fushës së menaxhimit të riskut. Gjithashtu, ky program u jep mundësi studentëve që mbarojnë studimet, të specializohen me njohuri të avancuara të përdorimit të teknikave të vleresimit dhe menaxghimit të risqeve në sektorin financiar, kryesisht privat, si dhe në sektoret e tjere të ndikuar nga risqet të naturave të tjera. Kjo u jep më shumë mundësi në tregun e punës, sidomos në sektorin financiar dhe real të ekonomise.<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me | Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare të universiteteve partnere të projekteve të perbashketa. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve jo vetem në segmentin e sektorit |

| | |
|---|---|
| pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | financiar e bankar por edhe pranë instituioneve që mbulojnë sektore reale të ekonomise apo instituteve monitoruese të tregjeve të sektoreve të tjere.<br><br>*Evidenca nr.16.8. Propozim perhapjen e programit të studimit*<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Puna pergatitore që në fazen e hartimit të programit nga Departamenti i Financës se bashku me universitetet partnere në projekt është plotesuar me realizimin e diskutimeve të hapura në tryeza të rrumbullakta apo konferenca të organizuara nga Departamenti i Financës dhe FE me me perfaqesues të institucioneve publike edhe me gjere në funksion të tregut të punes. Keto zhvillime lidhen edhe me fektet e krizave financiare të fundit, situaten pandemike, apo edhe të pasojave të tërmetit të Nentorit 2019 që natyrisht kanë kerkuar një qasje me koherente të menaxhimit të riskut në dege apo sektore të ekonomise.<br><br>*Evidenca nr.22.Workshope*<br><br>*Evidenca nr.23.1; 23.2 dhe 23.3: Konferena në kuader të projektit K-force, FE dhe DF.* |
| **Kriteri 10.** Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve | Programi është një bazë e mirë lidhur me mundësinë në të ardhmen për studentët e diplomuar për të pasur mundësinë e fillimit të programit të ciklit të tretë të studimit (Doktoraturë) pasi ky program u jep mundësinë e përdorimit të aparatit matematikor, statistikor, ekonometrik dhe informatikë në realizimin e një metodologjie bashkëkohorepër punime të doktoraturës nga kandidate që kanë perfunduar kete program.<br><br>*Evidenca nr.16.8. Propozim perhapjen e programit të studimit*<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.<br><br>**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | Departamenti i Financës është njesia bazë pergjegjese që mbulon zhvillimin e ketij programi. Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit është kryesisht staf nga ky department. Në varesi të fokusit të lendeve të veçanta janë të angazhuar edhe personel akademik nga Departamenti i Kontabilitetit, Departamenti i Statistikes dhe Informatikes dhe Departamenti i Ekonomiksit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton që mbulimi i ketij programi që nga viti 2018-2019 që është hapur dhe deri kete vit akademik ka pasur prirjrje të zhvillohet nga PAE. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin Msc në "Menaxhim Risku " për gjatë tre viteve të fundit akademike janë si më poshtë: |

| Kualifikimi i stafit akademik të PS | **2019-2020** | | **2020-2021** | | **2021-2022** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |
| Prof. Dr | 2 | 1 | 1 | - | 1 | - |
| Prof. Asoc. | 4 | - | 4 | 1 | 4 | 1 |
| Dr/Phd | 5 | - | 7 | - | 8 | - |
| Msc. | - | 4 | - | 1 | - | - |
| **Gjithsej** | **11** | **5** | **12** | **2** | **13** | **1** |

Nga verifikimi i të dhënave statistikore *(ref. Tabelave 12),* u konstatua se për tre vitet akademike mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, PAE. Konkretisht:

| Viti | Total orësh | PAE | PAK | PAE/PAK (%) |
|---|---|---|---|---|
| 2019-2020 | 870 | 750 | 120 | 86% / 14 % |
| 2020-2021 | 900 | 830 | 70 | 92% / 8% |
| 2021-2022 | 840 | 800 | 40 | 95% / 5% |

Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% te ngarkesës përmbushet **plotësisht.**

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr.16.7. CV e stafit akademik të angazhuar në program*<br><br>*Evidenca nr.40. Permbledhset e tabelave të RVB* |
| **Kriteri 3.** Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar në përputhje me objektin apo fokusin e modulit/lëndës që zhvillon në program. Kualifikimet e stafit dhe eksperienca e tyre përputhen me derjtimin e programit me fokus menaxhimin e riskut. Stafi i angazhuar në program ka realizuar mobilitete trajnuese në kuader të projekteve me universitete partnere të huaja si dhe ka marre pjese aktive në evenimente shkencore të organizuara nga njesia kryesore/baze si dhe universitete të tjera.<br><br>*Evidenca nr.16.7. CV e stafit akademik të angazhuar në program*<br><br>*Evidenca nr.27.1.Lista e mobiliteteve të stafit akademik* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Stafi akademik që mbulon këtë program është angazhuar në ndjekjen e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve. Nga vizita në institucion, në takimin me stafin që mbulon këtë program, GVJ evidentoi që anëtarë të stafit janë caktuar për të ndjekur si praktikën e studentëve të këtij viti akademik që tashmë e kishin përfunduar, ashtu edhe si drejtues për punimin e mikrotezës.<br><br>*Evidenca nr.17.Paketa e praktikes mesimore*<br><br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes MSH në MR.*<br><br>*Konstatime gjate vizites në institucion.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit | Fakulteti i Ekonomisë si njesia kryesore dhe Departamenti i Financës si njesi bazë ofron personel ndihmës mësimor shkencor dhe infrastrukturen e nevojeshme për realizimin e orëve laboratorike apo shërbime të tjera në funksion të procesit mësimor. në kuader të projektit Erasmus + "K-Force" është në funksion laboratori i Fakultetit ku për lende të veçanta zhvillohen punë laboratorike sidomos për temat që lidhen me modelimet e riskut apo perpunime të te dhenave me programet ekonometrike. Oret në laborator zhvillohen nga pedagogu përkatës, ndërsa personeli ndihmës që është pjese e stafit të Departamentit të Financës dhe personi pergjegjes në laborator orienton studentët lidhur me anën teknike të përdorimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.<br><br>*Evidenca nr.40. Permbledhset e tabelave të RVB* |

| | Konstatime gjate vizites në institucion | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | [illegible] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.6** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Hapja e ketij programi në kuader të projektit K-Force është paraprire nga ndermarja e një studimi tregu në të gjitha vendet e perfshira në program perfshire edhe vendin tone. në pasqyrat përmbledhëse të studimit bazuar në pyetesoret jepen edhe mundesite e punesimit të studenteve që mbarojnë kete program.<br><br>Fakulteti i Ekonomise si njesi kryesore e programit ka nenshkruar 37 marreveshje bashkepunimi me institucione financiare (bankare jo bankare etj) dhe organizata ekonomike publike dhe private në të cilat ka klauzola për mundesinë e punesimit prej tyre të studenteve që perfundojnë studimet në kete Fakultet. Në sherbim të ketij qellimi janë edhe konferencat e zhvilluara në rang Fakulteti edhe nga Departamenti i Financës që gjate 5 viteve të fundit kanë qenë të pervitshme( perjashto periudhen e pandemise). Edhe organizimi i disa workshopeve nga Departamenti i Financës ka ndihmuar në kuader të zhvillimeve të reja në tregun e punes.<br><br>*Evidenca nr.21: Lista e marreveshjeve të bashkepunimit në nivel FEUT,*<br><br>*Evidenca nr.21: Marreveshjet e bashkepunimit në nivel FEUT*<br><br>*Evidenca nr.22: Workshope të organizuara nga Departamenti*<br><br>*Evidenca nr.23.1/2/3: Konferenca të organizuara në kuader të projektit K-Force, Fakulteti dhe Departamenti:Lista e marreveshjeve të bashkepunimit në nivel FE te UT* |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në | Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, u evidentua përfshirja e studentëve në përmirësimet në programin |

| | |
|---|---|
| diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | përkatës. Studentët e këtij programi kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me procesin e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve, të shpërndara për ta në fund të semestrit përkatës nga Departamenti i Financës, si dhe nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me pedagoget e lendeve. Edhe pyetesori për studentet i hartuar në kuader të projektit K-Force është realizuar në funksion edhe të ketij qellimi.<br>*Vizita në institucion dhe takimi me studentet e programit,*<br>*Evidenca nr.24. leksione të hapura me studentet* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. | Megjise ky program studimi perfshin dy breza studentesh që janë diplomuar në kete program, keta të fundit janë ftuar në diskutimet që janë zhvilluar në Fakultet në kuader të workshop-eve të organizuara, ku evidentuam edhe diskutimin e tyre.(workshop i dates 24.3.2022 )<br>*Evidenca nr.45.2.Fjalim i students Alumni në workshop.* |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucioNë kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi | Puna pergatitore për hapjen e ketij programi në kuader të projektit K-Force ka perfshire edhe perqasjen e programit në funksion edhe të veprimtarise në sektore të ekonomise me fokus menaxhimin e riskut të lidhurra me ngjarjet në ekonomi-finance, energji, ambjent, katastrofat natyrore etj.<br>*Evidenca nr.14.Plani strategjik i programit MSHMR*<br>*Evidenca nr.15. Konsultim me focus grup për klimen* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Në programin e studimit përcaktohen qartë objektivat kryesore të tij në funksion edhe të kërkimit shkencor nëpërmjet marrjes së njohurive të thelluara dhe të avancuara në fushën e menaxhimit të riskut të cilat janë pjese e objektivave madhore të institucionit.<br>*Evidenca nr. 14.Plani strategjik i programit MSHMR*<br>*Evidenca nr. 16.Dosja e progeramit të studimit* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Gjate vizites në institucion në takimin me stafin e këtij programi u evidentua respektimi i lirisë akademike të percaktuara në aktet nenligjore. Bazuar në nivelin dhe nevojat e studentëve, pedagogë të caktuar na argumentuan axhustime në program sidomos me zhvillimin e modeleve aplikative gjate trajtimit të projekteve të kursit apo perdorimin e modeleve ekonometrike në laborator. *Takim me stafin e programit gjate vizites në institucion.* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Për vetë specifikën e ketij programi i fokusuar në menaxhimin e riskut ai u jep mundesi studenteve të motivohen në pergatitjen e projekteve të kursit duke u dhenë atyre karakterin e një punimi teoriko shkencort dhe aplikativ. Menaxhimi i riskut financiar, riskut të katastrpfave, atij mjedisor apo të energjiseai janë një fokus i gjere për ndermarjen e punimeve shkencore dhe aplikative. Fakulteti i Ekonomise dhe Departamenti i Financës tashme kanë një eksperjencee disa vjeçare edhe në organizimin e konferencave studentore duke u dhenë mundesi studenteve të pergartisin prezantime teoriko shkencore edhe në fushen e menaxhimit të riskut.<br><br>*Takimi me studentet gjate vizites në institucion*<br><br>*Evidenca nr.23.4. Konferenca studentore* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | Programi i studimit është paraprire nga një studim në kuader të projektit K-Force në të cilin perfshihen elementet e plote te nje politike studimore dhe analize. Edhe plani strategjik i programit bazohet në strategjinë e zhvillimit të UT për vitet 2018-2023.<br><br>Për vetë zhvillimet e intensive të ndodhura gjate 3-4 viteve të fundit dhe që prekin thelbin e ketij program (tërmeti i vitit 2019, situate pandemike, kriza financiare dhe energjitike e ketij viti ) mendojme se është evidente hartimi i një politike studimore kombetare dhe rajonale në funksion të fokusit të programit.<br><br>*Evidenca nr.14. Plani strategjik i programit* |
| **Kriteri 5.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe | Departamenti i Financës në permbushje të aktiveiteteve kerkimore shkencore ka pasur si burim financimi fondet e projekteve Erasmus + si dhe mbeshtetje nga institucioni. Nga takimi ne institucion u informuam qe ne dispozicion te Dep. jane akorduar shume prej 1 milion leke per mbeshtetje te |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme | kerkimit shkencor dhe botiimeve por nuk evidentuam praktike e perdorimit te ketij fondi. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **[illegible]** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.8**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet se Institucioni është aktiv në realizimin e projekteve dhe iniciativave shkencore. Bazuar në dosjen e aplikimit evidentojme se për periudhen 2018-2022 në kuader të FE janë 48 aplikime aplikime për projekte në kuader të thirrjeve kombetare (18 të tilla) dhe nderkombetare (27 të tilla). UT krahas thirrjes për projekte mbeshtet financiarisht edhe financimet permes sigurimit të fondeve publike të dhena nga AKKSHI apo AKFAL për projekte rajonale dhe nderkombetare.<br>*Evidenca nr.26:Thirrje për projekte në kuader të programit "UT-kerkim,ekselenc , inovacion".*<br>*Evidenca nr.26.1:Aplikime dhe projekte në zbatim në kuader të thirrjeve kombetare dhe nderkombetare në FE 2018-2022.* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | FE si njesi kryesore dhe Departamenti i Financës si njesi bazëe zhvillimit të programit është aktive në përfshirjen e personelit akademik dhe studentët në realizimin e studimeve dhe analizave të ndryshme. janë 5 projekte në proces implementimi ku janë përfshirë staf akademik dhe studentë. Nga ana tjetër, studentët janë perfshire në kuader të 3 konferencave të fundit nderkombetare në realizimin e studimeve të perbashketa. Gjatë periudhës së praktikës profesionale dhe përgatitjes së mikrotezës, shikohet edhe angazhimi i studenteve në pergatitjen e punimeve shkencore.<br>*Evidenca nr.23.3 dhe 23.4: konferenca të organizuara nga FE dhe Departamenti i Finances.*<br>*Evidenca nr.26.1: Aplikime dhe projekte në zbatim në kuader të thirrjeve kombetare dhe nderkombetare në FE 2018-2022.* |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia | Institucioni, gjatë viteve të fundit, ka qenë aktiv në organizimin e aktiviteteve promovuese, konferencave |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave | shkencore të organizuara në institucion ose jashtë tij, ku pjesëmarrja e studentëve ka qenë e kënaqshme. Bazuar në Raportin e aktivitetit kërkimor shkencor të UMT për periudhën 2017-2020 janë organizuar aktivitete shkencore të tilla si:<br>3 Konferenca Studentore;<br>Simpoziumi shkencor;<br>Konkursi i inovacionit;<br>Tre botime në revistën shkencore të UMT; |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1<br>Institucionin adjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. | Bazuar në dokumentacionin e aplikimit të institucionit si dhe nga takimi me stafin akademik që zhvillon kete program verejme se në kuader të projektit K-Force në startim të programit janë perfshire praktikat me të mira të metodave të ndryshme bashkekohore të mesimdhenies në fushen e lendeve të menaxhimit të riskut. Gjithashtu në kete faze është bere edhe trajnimi për metodologjinë e mesimdhenies në kuader të projektit. Në vijimësi lidhur me këtë kriter vleresimi në Maj të ketij viti është realizuar edhe trajnimi i 48 pedagogeve të rinj të FE me objekt pedagogjinë dhe metodologjinë e |

| | |
|---|---|
| | mesimdhenies. Gjithashtu në kuader të zhvillimit të mesimit online gjate periudhes pandemike UT ka hartuar udhezuesin perkates të për zhvillimin e mesimit në distance, ku trajtohet edhe metodologjia e mesimdhenies.<br><br>Megjithese institucioni në Strategjinë e zhvillimit të UT 2018-2023 ka trajtuar edhe aspektet e mesimdhenies, *ende mungon një udhezues në nivelin institucional që të kete si objekt zhvillimin dhe perdorimin e metodave të ndryshme dhe bashkekohore të mesimdhenies sipas fushes se studimit.*<br><br>*Evidenca 25.5.1: Raporti mbi pershtatjen e metodologjive të mesimdhenies në kuader të projektit K-Force.*<br><br>*Evidenca 25.5.2: Raporti mbi perdorimin e platformes ICT në kuader të projektit K-Force.*<br><br>*Evidenca 25.5: Trajnime për metodologjinë e mesimdhenies në kuader të projektit K-Force.*<br><br>*Evidenca 29: Udhezues i UT për perdorimin e sistemit të mesimdhenies në distance.*<br><br>*Evidenca 31: Trajnim për metodologjinë e mesimdhenies stafi i ri akademik* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Bazuar në organigramën e institucionit dhe FE, në manualin e cilësisë të UT si dhe në takimet e realizuara në institucion, monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësisë mësimdhënëse të stafit akademik dhe ndihmës të programit realizohet në nivel institucional nga Komisioni i Perhershem për Sigurimin e Standardeve të cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Perhershem i Kurrikules. Duhet theksuar se institucioni në zbatim të ligjit gjate 2 viteve të fundit ka pershtatur dhe hartuar dhe kuadrin rregullator të monitorimit dhe vleresimit të cilësisë nepermjet miratimit të "Manualit të Cilesise"; Rregulloren "Per sigurimin e cilësisë në UT " dhe "Paketen e instrumenteve të cilesise" ku u ngrit edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëme të Cilësisë (NJSBC). Bazuar në keto vendime të UT edhe FE si njesi kryesore ka ngritur Degen e Sigurimit të cilësisë si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëme të Cilësisë (NJSBC), që operon në bazë të rregullores perkatese.<br><br>Këto dy struktura përgjegjëse monitorojnë dhe vlerësojnë periodikisht mësimdhënien nëpërmjet performancës akademike që kryen Departamenti si dhe anketimeve me studentët e programit në fund të çdo semestri. Ky vlerësim |

| | |
|---|---|
| | paraqitet në formën e një raporti të veçantë dhe u paraqitet instancave përkatëse për analizë të mëtejshme dhe miratim. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimmarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit të Financës.<br><br>Në takim me stafin që mbulon programin një mënyrë tjetër vlerësimi është edhe hartimi në fillim të vitit akademik i planit të ngarkeses mesimore shkencore për secilin pedagog, i cili monitorohet për zbatim nga drejtuesi i Fakultetit dhe Departamentit. Përmbushja e këtij plani pune është një nga vlerësimet e performances se pedagogut.<br><br>Nga shqyrtimi i ngarkeses mesimore të personelit akademik që mbulon këtë program, verejmë që disa prej tyre zhvilloje 4 apo 5 lëndë ( në disa programe studimi) dhe kane një ngarkese mesimore ndermjet 400 deri 450 orë mësimore që konsiderohet disi e lartë.<br><br>*Mendojme se periudha e shkurter e operimit të NJSBC në rang institucioni dhe njesie kryesore e ben të domosdoshme realizimin e objektivave të saj nepermjet rritjes se intensitetit të punes se tyre.*<br><br>*Evidenca nr.46.Vendim nr.1 date 28.9.2021"Per miratimin e NJSBC në FE*<br><br>*Evidenca nr.46.2.Vendim nr.51. "Per miratimin e paketes se dokumenteve për sigurimin e cilesisë*<br><br>*Evidenca nr.46.1.Manuali i cilesisë*<br><br>*Evidenca nr.46.3.Rregullore e NJSBC të FE* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Bazuar në kuadrin rregullator të UT dhe FE, nëpërmjet strukturave përkatëse, realizohet vlerësimi periodik i mesimdhenies dhe veprimtarisë akademike dhe administrative nga ana e studentëve përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.<br><br>• Metoda të tërthorta: kryesisht në formën e pyetesoreve me studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Ky anketim zhvillohet dy herë në vit në fund të çdo semestri. Rezultatet e anketimit bëhen të ditura stafit nëpërmjet raportit të dalë për këtë qëllim, i cili analizohet në mbledhjen e Departamentit dhe që shërben për të përmirësuar punën në të ardhmen. Nga shqyrtimi i modeleve të pyetesoreve që plotesojin studentet si për |

| | |
|---|---|
| | pedagogun ashtu edhe për lenden perkatese rezulton se nepermjet tyre arrihet të vleresohen të gjithe elementet e procesit. Studentet nepermjet pyetesorit të veçante vleresonin edhe procesin e praktikes profesionale. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të Institucionit, atyre të Fakulteteve dhe Departamenteve ku edhe analizohen si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik;<br>• Metoda të drejtpërdrejta: përfshijnë vlerësimin me pikë për stafin në bazë të formularit të caktuar. Në skedën përkatëse të vlerësimit të pedagogut u evidentua një praktikë vlerësimi të një pedagogu të ri në mbarim të kontrates se perkoheshme që sherben si bazëper neneshkrimin e kontrates perfundimtare. Vleresimi behej për mesimdhenien punen kerkimore dhe kontributin në institucion;<br>*Evidenca nr.6.Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT*<br>*Evidenca nr.46.1.Manuali i cilesise*<br>*Evidenca nr.46.3.Rregullore e NJSBC të FE*<br>*Dokumente shtese të siguruara pas vizites në institucion:*<br>*Pyetesor vleresimi nga studentet për pedagogun*<br>*Pyetesor vleresimi nga studentet për praktiken*<br>*Pyetesor vleresimi nga studentet për lenden* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Strukturat përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies, NJBSC të FE dhe Departamenti i Financës përgatitin dhe shpërndajnë në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë e mësimdhënies, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese në nivel Fakulteti dhe Departamenti por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Në analizen mesimore shkencore që realizohet në Departament në evidentuam problematikat e dala gjate vitit akademik në procesin mesimor, shkencor dhe realizimin e praktikes profesionale.<br>*Evidenca 20.3 .Analiza vjetore e Departamentit të Financës 20-21*<br>*Takimi me studentet dhe stafin e programit gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të | Ngritja e ketij program studimi në kuader të projektit K-Force është bazuar edhe në eksperjencat me të mira nga universitetet |

| | |
|---|---|
| vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies | partnere në projekt. Nga ana tjeter kemi promovim të stafit të programit për permiresimin e metejshem të mesimdhenies nepermjet mobiliteteve në kuader të programit ERASMUS + si edhe të trajnimeve pedagogjike të mesimdhenies nepermjet trajnimeve perkatese. Eksperienca dhe kualifikimi i stafit akademik që zhvillon kete program është edhe një faktor i rendesishem në realizimin me cilesi të objektivave të tij.<br><br>*Permbledhese e tabelave*<br><br>*Evidenca 31: Trajnim për metodologjinë e mesimdhenies stafi i ri akademik* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.2**<br><br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Mësimdhënia në programin MSH në "Menaxhim Risku" bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional, rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë si dhe në rregulloren e ketij programi në të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione, seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 15 lëndë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara.<br><br>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e "ndërtuar", kjo do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat janë të ndara kryesisht në: |

| | |
|---|---|
| | • 10 % frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit;<br>• 30 % provim i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit;<br>• 60% provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit.<br><br>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.<br><br>*Evidenca nr.6. Rregullore për sigurimin e cilësisë e UT*<br><br>*Evidenca nr.16.3. Rregullorja e programit të studimit MSH në MR*<br><br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimr i programit*<br><br>*Evidenca nr.16.5 dhe 16.6. Programet mesimore të lendeve 2020-2021 dhe 2021-2022*<br><br>*Evidenca nr.40.Tabelat përmbledhëse nr.13 dhe 15* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies (shih dhe vlerësimet më lart). Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh në tre raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca aplikative të modeleve ekonometrike duke rritur nivelin kerkues e shkencor të mësimnxënies nga studentët. Në mbeshtetje të një performace me të mire mesimdhenieje stafit të programit i kanë sherbyer edhe mobititetet e realizuara në kauder të disa programeve ERASMUS + të viteve të fundit. për stafin e ri akademik janë organizuar edhe trajnime specifike metodologjike.<br><br>*Evidenca 16.7.CV e stafit akademik*<br><br>*Evidenca 27.1. Lista e mobiliteteve të stafit akademik*<br><br>*Evidenca nr,.31.Trajnime metodologji mesimdhenie për stafin e ri akademik*<br><br>*Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme | Bazuar në takimin me stafin e Departamentit të Financës rezulton se FE i UT mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +. |

| | |
|---|---|
| dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, Institucioni ka organizuar trajnime të strukturuara në nivel universiteti dhe Fakulteti me ekspertë të fushës së pedagogjisë. Në funksion të permiresimit të procesit të mesmdhenies në buxhet e FE të UT planifikohen fonde për permiresimin e bazes laboratorike, shtimin e fondit të librave etj. Studimi i tregut që parapriu hapjen e programit në kuader të projektit K-Forse ka vijuar edhe me intervista të strukturuara me drejtues institucionesh në funksion kjo edhe të permiresimit të metodave të mesimdhenies. në kuader edhe rte zhvillimeve të viteve të fundit stafi akademik ka perdorur edhe platformat e njohura të mesimdhenies onliNë si e-learning Microsoft Teams apo Google Classroom<br>*Takimi me stafin akademik dhe studentët e programit*<br>*Evidenca nr,.31.Trajnime metodologji mesimdhenie për stafin e ri akademik*<br>*Evidenca nr.37.Buxheti i miratuar për vitet 2019, 2020 dhe 2021* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën e duhur për një proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik që mbulon kete program, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Financës dhe menaxhimit të riskut të biznesit dhe ate financiar, energjitik etj.<br>*Evidenca nr.16.7 CV e stafit akademik të programit*<br>*Takim me stafin* |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. Ky sugjerim theksonte përdorimin më të madh të rasteve studimore dhe modeleve ekonometrike. E tillë konsiderohet rritja e orëve të aplikimit praktik në lëndët e modelimit dhe ekonometrisë,e evidentuar nga takimi me studentët. *Takimi me studentet gjate vizites në institucion.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Eksperienca në mësimdhënie e stafit të programit bën që të përdoren format interaktive duke ndërthurur trajtimin teorik me atë aplikativ. Një zhvillim të mëtejshëm të këtyre metodave e përben dhe realizimi i mësimit online gjatë situatës pandemike. një ndihmese në kete drejtim e ka dhenë edhe realizimi i disa workshop-eve me pjesemarrjen edhe të studenteve të organizuara nga Departamenti i Financës ku synohet terheqja e mendimit të studenteve. *Evidenca nr.22.Workshope, nga Dep.i Finances* |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre | Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Vetë karakteri aplikativ i disa lëndëve, sidomos të modelimit dhe menaxhimit, rrisin pavarësinë e studentit në këtë proces. *Takimi me studentet gjate vizites në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Ky program studimi realizohet në godinen A dhe B tashme të rikonstruktuar të FE të UT. GVJ vizitoi infrastrukturën e kësaj godine dhe konstatohet që në dispozicion të procesit mësimor janë ambjente të pershtatshme që plotesojnë maksimalisht procesin normal të mesimit. të gjitha sallat e leksioneve, seminareve, bibloteka e FE janë të pajisura me se miri me mjetet e nevojeshme didaktike dhe teknologjike. Investimi i fundit që tashme ka perfunduar ka rritur me tej cilesinë e infrastruktures mesimore si për studentet ashtu edhe për stafin akademik. Edhe zyrat e personelit akademik ishin konceptuar dhe realizuar në formen e permbajtjes bashkekohore me qellim rritjen e eficences. Të gjitha ambjentet janë tashme të perfshira në sistemin ngrohje ftohje |

| | |
|---|---|
| | qendror, falë kjo e investimit të sapoperfunduar. Edhe laboratori i Departamentit të Financës si dhe salla e konferencave dhe takimeve me studentet janë të pajisura me të gjithe mjetet e nevojeshme dhe kapacitetet e perballimit të numrit të studenteve dhe stafit.<br><br>*Evidenca nr.40. Permbledhse e tabelave; tabela nr.16.*<br><br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave. | Ambientet ku zhvillon mësimin ky program studimi janë funksionale dhe ofrojnë logjistikën e nevojshme në shërbim të procesit mësimor. Laboratori i Departamentit të Financës ofron kapacitetin e nevojshëm për të realizuar nevojat e programit në shfrytëzimin e kësaj teknologjie. Për zhvillimin e mësimit pedagogët përdorin video projektorët të cilët së bashku me kompjuterin janë të instaluar në sallën e leksionit.<br><br>*Evidenca nr.40. Permbledhse e tabelave; tabela nr.16.*<br><br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | Nga vizita në institucion GVJ evidentoi që të gjitha sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratori perkates perdorin sisteme bashkekohore të informatikes në funksion të realizimit të procesit mesimor. Paisjet kompjuterike dhe aksesoret e tyre kanë të instaluar softe aplikative të kohes si program modelimi STATA; EViews etj.<br><br>*Evidenca nr.40. Permbledhse e tabelave; tabela nr.16.*<br><br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e aplikimit nga institucioni si dhe në viziten që GVJ realizoi në ambjentet e FE të UT evidentojme që për modulet/lendet e programit studenteve u ofrohet dhe literatura bazëdhe ndihmese siç edhe janë të percaktuara në syllabuset perkatese.<br><br>Në mbeshtetje të procesit të mesimnxenies FE i UT ka në funksionim edhe biblioteken e tij ku studentet kanë mundesi të marrjes se njohurive të programit si fizike (nepermjet teksteve perkatese) ashtu edhe digjitale. Kjo e fundit realizohet nepermjet programit Cobiss që u mundeson perdoruesve akses online. Ngritja e ketij programi studimi në kuader të projektit K-Force ka mundesuar edhe financimin e teksteve bazë dhe ndihmese kryesisht në gjuhen angleze, gje që është normale për një student të programit MSH të shfrytezoje literature në kete gjuhë. |

| | |
|---|---|
| | *Vizita në institucion*<br>*Evidenca nr.35.1 Relacion i bibliotekes*<br>*Evidenca nr.35.4. Lista e librave të prokuruara për programin e studimit MSHMR* |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Bazuar në vizitën që GVJ realizoi në bibliotekë rezulton se ka literaturë relativisht të mjaftueshme, tekste mësimore në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Ne evidentuam listen e titujve të disponueshëm për pedagogët dhe studentët dhe seksioni në ndihmë të programeve të shkencave ekonomike. Bazuar në listën e inventarit të librave në fushën e finances, biblioteka ofron një fond relativisht të mjaftueshëm librash në shqip (rreth 2500 tituj) dhe anglisht ( rreth 2700) që janë në ndihmë të studentëve si dhe rreth 240 numr revistash periodike. Sipas rregullores se programit të ciklit të trete në biblioteke janë të depozituar edhe kopje të punimeve të doktoratures të mbrojtura pranë Fe të UT.<br>Studentet kanë në perdorim biblioteken digjitale JSTOR me akses në mjaft të gjere në revista akademike (mbi 12 miljion artikuk) apo libra (mbi 85,000 të tilla).<br>FE i UT tashme është pjese e platformes online RASH (Rjeti Akademik Shqiptar) që mundeson kerkimin dhe gjetjen e revistave , e-books, dhe punimeve të tjera. Kapaciteti i bibliotekes është afro 100 vende në dy salla perkatese të paisura me kompjuteradhe nen kujdesin e personelit të saj.<br>Orari i punes se bibliotekes është 8.30 deri 19.30 orar i pershtatshem për studentet e ketij programi që e zhvillojNë mesimin pasdite<br>*Vizita në institucion*<br>*Evidenca 35. Rregullore e bibliotekes.*<br>*Evidenca nr.35.1 Relacion i bibliotekes*<br>*Evidenca nr.35.4. Lista e librave të prokuruara për programin e studimit MSHMR* |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Personeli akademik dhe studentët kanë akses online në bibliotekën e institucionit duke shfrytëzuar literaturën e fushës përkatëse për tekste universitare, libra dhe artikuj shkencorë. Sektori i IT i universitetit mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në bibliotekë të dy sistemeve me fonde të hapura dhe fonde të mbyllura.<br>*Vizita në biblioteken e institucionit* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr.35.2:Marreveshjet për biblioteken online* |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Nga vizita në laboratorët e përmendur me lart,bëhet i mundur realizimi i njohurive aplikative i lëndëve përkatëse si dhe i punimeve të detyrave të kursit apo diplomimit të tyre.<br>*Vizita në biblioteken dhe laboratorin e institucionit* |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Në funksion të procesit mësimor personeli akademik dhe studentët përdorin platformën online në hedhjen e materialeve mësimore dhe informimin e studentëve mbi procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pedagogë të caktuar përdorin platformat elektronike të komunikimit on-line në raste të caktuara për komunikim me studentët, siç janë: google classroom, zoom, si dhe platformen e-learning Microsoft Teams; platformen e-learning Canvas-etj.<br>Evidentohet përdorimi i ketyre platformave në mesimdhenie gjate situatës pandemike, që përkoi me semestrin e dytë me studentet e kursit të parë.<br>*Evidenca nr.32dhe 32.2 Trajnim stafi i DF për perdorimin e platformes e-learning Microsoft Teams dhe platformen e-learning Canvas* |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Personeli akademik dhe studentët përdorin komunikimin elektronik që disponon institucioni të permendur me siper për marrje materialesh mësimore studimore apo shkencore duke komunikuar kështu në kohe reale.<br>*Evidenca nr.32; 32.1 dhe 32.2 Trajnim stafi i DF për perdorimin e platformes e-learning Microsoft Teams dhe platformen e-learning Canvas dhe Outlook Print Screen* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre | Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre që në fillim të periudhës përkatëse që perkon me semestrin e pare të vitit të dyte dhe gjatë përgatitjes së tyre. U evidentua edhe në takimin me studentët që ishin në këtë fazë, orientimi i studentëve nga pedagogët udhëheqës që ishin miratuar, si dhe procedurat e shkruara që orientonin studentët në këtë proces.<br>*Takimi me studentet e programit*<br>*Evidenca nr 18. .Paketa e Mikrotezes* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.4<br><br>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit evidentojme se tashme janë miratuar dhe operojnë strukturat e sigurimit të brendshem të cilësisë në nivel instituioni dhe njesie kryesore. në nivel institucioni operojnë Komisioni i Perhershem i Cilësisë dhe Njesisa e Brendshme e Sigurimit të Cilesise. Në kuadër të plotësimit të kërkesave ligjore dhe nënligjore është ngritur edhe në nivel të njësisë kryesore (FE), Njësinë e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit. NJBSC koordinon punën me njësinë bazë që është Departamenti i Financës si njesi bazë e ketij programi. Departamenti ka të caktuar një koordinator/mbikëqyrës të programit që mban kontakte të vazhdueshme me NJBSC-në. në mbeshtetje të punes se NJBSC në nivel Fakulteti operon edhe Zv.Dekani për sigurimin e cilësisë si dhe dega e sigurimit të cilesise,<br><br>*Megjithese NJBSC në nivel të njësisë kryesore ka hartuar planin e veprimit të saj, fakti që ngritja e kesaj njesie është bere në vitin 2021 ben që të mungoje eksperienca dhe historiku i duhur për evidentimin pergjate viteve të problematikave që kjo structure monitoron dhe vlereson.*<br><br>*Evidenca nr.6 "Rregullore për sigurimin e silesise në UT*<br>*Evidenca nr.46. Vendim nr.11 dt.28.9.2021 "Per miratimin e NJBSC në FE të UT"*<br>*Evidenca nr.46.1. Manualui i cilësisë në UT*<br>*Evidenca nr.46.3. Plan veprimi i NJBSC të FE të UT*<br>*Evidence nr.40. Tabela nr.24* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron. | Fakulteti i Ekonomisë si njësia kryesore dhe Departamenti Financës si njësia bazë ndjekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nivelin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së programit dhe cilësisë së tij e ka Departamenti i Financës i cili bën analiza periodike dhe raporton tek Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë dhe pranë NJBSC-së, e përcaktuar kjo edhe në planin e punës që hartojnë njësitë përkatëse për vitin akademik.<br><br>*Evidenca nr. 20.4.Raporti i koordinatorit të programit MSH në MR.*<br><br>*Evidenca nr.20.3. Analiza vjetore e Departamentit të Financës 2021* |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Ngrita dhe operimi i ketij program në kuader të projektit nderkombetar K-force u ka dhenë mundesi stafit që mbulon kete program të realizojnë mobilitete trajnuese pranë institucioneve homologe të vendeve partnere duke rritur keshtu nivelin e mesimdhenies. Edhe mobilitetet e tjera në kuader të projektit ERASMUS + si dhe worksheet e organizuara nga departamenti i Financës kanë qeNë në funksion të ketij qellimi.<br><br>*Evidenca nr.25.5 Raporti për pershtatjen e metodologjise se mesimdhenies në kuader të projektit K-Force*<br><br>*Evidenca nr.27.1: Lista e mobiliteteve të stafit akademik* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ evidentoi përpjekje të stafit të programit për të rritur kualifikimin e tyre dhe marrë eksperienca të reja në procesin mësimor e shkencor. Kjo është realizuar nëpërmjet vizitave që anëtarë të stafit kanë realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit ERASMUS, pjesëmarrje të stafit në disa projekte kërkimore shkencore si dhe në prezantime të punimeve të tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në ato të organizuara nga vete Departamenti i Finances. Gjate takimit me stafin e programit në identifikuam dhe mbeshteje financiare për antare të tij në pjesemarrjen në konferenca nderkombetare<br><br>*Evidenca nr.23: Vendim Senati 22.07.2021"Per programin e grantit për prezantim punimi, kerkimi në konferenca nderkombetare"* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr.23.1; 2 dhe 3:Konferenca në kuader të projektit K-Force si dhe të organizuara nga FE i UT dhe DF i FE të UT* |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Anëtarë të stafit të këtij programi kanë marrë pjesë në trajnime në nivel institucioni për metodologjinë e mesimdhenies që ndihmon në rritjen e kualifikimit të tyre me përdorimin e risive në fushën e teknologjisë digjitale etj. Ketij qellimi i ka sherbyer dhe veprimtaria e Qendres Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit ku kanë marre pjese antare të stafit akademik që mbulon kete program.<br><br>*Evidenca nr.27.1: Lista e mobiliteteve të stafit akademik*<br><br>*Evidenca nr. 31.Trajnime për metodologjin e mesimdhenies* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Nga takimi me stafin që mbulon këtë program u evidentua angazhim serioz i tij në zbatimin me përgjegjshmëri të realizimit të programit mësimor, duke i dhënë rendësi procesit të mësimnxënies nëpërmjet përdorimit të metodave aplikative sidomos në lëndët karakterizuese. Këtu ritheksojmë përdorimin e metodave aplikative bashkëkohore që përdoren nga institucionet financiare lidhur me menaxhimin e riskut.<br><br>*Evidenca nr.26.1 Aplikime dhe projekte në zbatim të thirrjeve kombetare dhe nderkombetare në Fe të UT*<br><br>*Vizita në institucion e GVJ* |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Eksperienca në mësimdhënie e numrit me të madh të personelit akademik që mbulon këtë program është një faktor i rëndësishëm për realizimin e procesit të mësimdhënies sa me bashkëkohor dhe të përmirësuara me arritjet në këtë drejtim. Marrja e eksperiencave nga stafi të metodave bashkëkohore të kolegeve të tyre pranë universiteteve të huaja është realizuar nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të projekteve ERASMUS ku institucioni është parter.<br><br>*Evidenca nr.25.4. Raport mbi progresin dhe kenaqesinë e studenteve*<br><br>*Evidenca nr.27.1: Lista e mobiliteteve të stafit akademik* |
| **Kriteri 8.** Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit | Bazuar në dokumentacionin e përcjellë për këtë program dhe vizitës në institucion, u evidentua fakti se institucioni ka miratuar një numër profesorësh të fushës akademike apo personalitete të njohura në organizatat publike dhe private |

| | |
|---|---|
| të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor | apo perfaqesuses të projekteve të huaja (GIZ, UNDP ) për të zhvilluar leksione të hapura për tema të veçanta dhe të trajtuara në mënyrë komplekse dhe inovative. *Evidenca nr.24. leksione të hapura* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | [illegible] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br><br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UT), njësisë kryesore (Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë) dhe rregulloren e këtij programi si dhe në manualin e zhvillimit të provimit. Këto dokumenta janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuara mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse.<br><br>*Evidence nr.2. Rregullore e UT*<br><br>*Evidenca nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR*<br><br>*Evidenca nr.52: Manuali i zhvillimit të provimeve të DF* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet:<br><br>• Informacionit të marrë në webin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te;<br>• Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre;<br><br>*Vizita në institucion në takimin me studentet dhe stafin e programit* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
www.ascal.al
Web site:
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara | Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduara dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që uevidentuan të përcaktuara në syllabuse në kriteret standarte.<br>*Evidenca nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR*<br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika vlerësimi të semestrit të dyte të Kursit të I- të të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve vlerësohen me 40% të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra/projektet e kursit), ndërsa provimi përfundimtar zë 60 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij.<br>*Vizita në institucion e GVJ*<br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Vitet e fundit UT dhe FE ka |

| | |
|---|---|
| | ndërrmarë iniciativë dhe ka aplikuar edhe me një pjese të lendeve të këtij programi sistemin elektronik të testimit në disa lëndë *(Projekti clean score).*<br>*Evidenca nr. 30 dhe 30.1: Marreveshje bashkepunimi mes AADF dhe UT për programin Clean Score) dhe relacioni perkates me shembull vleresimi* |
| **Kriteri 3.** Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Për realizimin e testimeve dhe vlerësimin e dijeve të studentëve Departamenti Financës, bazuar në rregulloret përkatëse, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënëshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i Departamentit të Financës. *Vizite e GVJ në sekretarinë mesimore* |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie. | Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga Departamenti Financës. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme. Në raste zhvillimit të testimit në laborator shtohet dhe personel mbikëqyrës gjatë zhvillimit të provimit.<br>*Evidenca nr. 30 dhe 30.1: Marreveshje bashkepunimi mes AADF dhe UT për programin Clean Score) dhe relacioni perkates me shembull vleresimi* |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi me 40% të pikëve të dijeve gjatë vitit jo vetëm i "mban të angazhuar" vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj. *Evidenca nr.52: Manuali i zhvillimit të provimeve të DF* |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë kryesore dhe bazë, Departamenti Financës monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve |

| | |
|---|---|
| | me njohuritë e kërkuara duke eleminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim.<br>*Institucioni nuk ka program antiplagjaturë që të evidentojë këtë mangësi për punimet e mikrotezave të studentit. Për të minimizuar këtë, nga takimi me stafin e departamentit, u evidentua rëndësia që i jepej punimit të mikrotezes, të bazuara në raste studimore si dhe deklarimi i autoresise nga ana e studentit në punimin e tij permbylles.*<br>*Evidenca nr.2.Rregullore e UT*<br>*Evidenca nr.5 ;Kodi i etikes i UT*<br>*Evidenca nr.18. Paketa e mikrotezes në MSH në MR (deklarata e studentit)* |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Realizimi me korrektësi i testimeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci për vlerësimin e saktë të studentëve. në nenet 46,47,48 dhe 49 të rregullores se UT percaktohet procedura e vleresimit të studenteve. në të percaktohet se përgjigjet e testimit merren nga studentët brenda 15 ditëve nga zhvillimi i tij dhe ata kanë të drejtën e reklamimit të tij brenda 5 diteve nga shpallja e tyre.<br>*Mendojme se afati 15 ditor i shpalljes se rezultateve është disi i gjate nisur edhe nga fakti që në rastin e programeve MSHMR grupet e studenteve janë optimale. Gjithashtu, mospefshirja e sekretarive mesimore në programin RASH apo ate tashme Pitagora nuk u siguron komoditet studenteve në marrjen e vleresimeve paraprake, megjithese aktualisht kete njoftim e marrin nepermjet emaileve apo programit e-learning-Microsoft Teams.*<br>*Evidenca nr.2.Rregullore e UT* |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një ditë reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin. *Vizita në institucion dhe takimi me studentet* |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e | Praktikat e ankimimit të studentëve lidhur me vlerësimin kanë qenë të pakta në numër, ndërsa nuk ka pasur të tilla për studentët e këtij programi. Por, në rastet e evidentuara, Departamenti ngre komision vlerësimi të posaçëm dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | procesi dokumentohet deri në fund. *Vizita në institucion dhe takimi me studentet* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi bazohet mbi njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit në Finance, ku FE i UT tashme ka një historik dhe eksperience sa pozitive aq edhe të gjate. Nga shqyrtimi i syllabusve vihet re që ka një trajtim fillimisht të koncepteve bazënë financë dhe ate të riskut që janë marrë në programin Bachelor. Ky trajtim është i domosdoshëm në kushtet kur në këtë program kanë mundësinë që ta ndjekin edhe studentë që nuk kanë mbaruar studimet e ciklit të parë në fushën e financës.<br><br>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e menaxhimit të riskut. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike që përfshijnë fushën e aplikimeve të programeve në menaxhim e riskut bankar të sigurimeve, të katastrofave, auditin apo modelimin e riskut në praktike. Mbështetur në 15 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teoriko shkencor dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e mikrotezes që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektivi dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve.<br><br>*Evidenca nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR*<br><br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e | Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e menaxhimin e |

| | |
|---|---|
| teknologjisë së informacionit, humaNë sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | riskut për disa nga sektoret e ekonomise. Modulet si "Auditim në bazërisku" apo Modelimi i Riskut në praktike" të gershetuara me "Probabilitetin në menaxhimin e riskut" zhvillojnë aftesi të veçanta për një menaxher të riskut që formohet me një bazëtë shendoshe matematikore dhe ekonometrike. I zhvilluar në kuadrin e projektit K-Force në kete program kanë dhenë leksione në anglisht profesore të iuniversiteteve të tjera partnere në projekt. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në lëndët që bazohen në modelime dhe programe informatike të aplikuara në këtë fushë.<br>*Evidenca nr.16.4. Plani mesimor i programit MSH në MR*<br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve*<br>*Evidenca nr.27.1. Lista e mobiliteteve të stafit akademik* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. | Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedohej mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit).<br>*Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet* |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Pedagogu i lëndës përkatëse, në fund të zhvillimit të mësimit, bën një përmbledhje të temave të trajtuara dhe orienton studentët lidhur me testin përfundimtar që do zhvillohet në sezonin e provimeve.<br>*Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Anëtarë të stafit kanë marrë eksperiencë dhe njohuri bashkëkohore mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, kryesisht nëpërmjet angazhimit individual, vizitave në institucione universitare të huaja në kuadër të projekteve ERASMUS, apo gjatë angazhimit në projekte. Mbeshtetur e dokumentacion evidentohet edhe realizimi i leksioneve të hapura me staf akademik të fushes apo specialiste të saj.<br>*Evidenca nr.24. leksione të hapura*<br>*Vizita në institucion dhe takimi me stafin e programit dhe studentet* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Bazuar në dokumentacion dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet punëve laboratorike. Më e theksuar kjo realizohet në lëndët e "Ekonometri", "Modelim i Riskut në praktike", etj, lëndë këto që në aplikimin e tyre kërkojnë edhe një angazhim shtesë jashtë kornizës së syllabusit duke u zhvilluar në laborator.<br>*Evidenca nr.16.6. Programet mesimore të lendeve*<br>*Vizita në institucion dhe takime me stafin dhe studentet* |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. | Stafi i programit diskuton gjatë zhvillimit të programit por sidomos në fund të tij çështje specifike që kryesisht kanë të bëjnë me aplikimin e njohurive të marra kryesisht në lëndët karakterizuese që lidhen me menaxhimin e riskut. Kjo u evidentua në takimin me stafin që mbulon këtë program.<br>*Vizita në institucion dhe takime me stafin dhe studentet* |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Stafi akademik që mbulon kete program realizon një bashkëbisedim dhe komunikim të frytshëm me studentët për të marrë nga ata sugjerimet me qëllim rritjen e cilësisë mësimdhënëse. Një element i rëndësishëm në funksion të këtij qëllimi është edhe pyetësori që plotesohet nga studentët në fund të semestrit ku në të ka rubrikë për këtë qëllim.<br>*Vizita në institucion dhe takime me stafin dhe studentet*<br>*Evidence nr 23.1. Konferenca në kuader të projektit K-Force* |
| **Kriteri 9.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët sidomos gjate realizimit të praktikes. U evidentua gjithashtu në një rast dhe mbeshtetja e institucionit të inisiativave të studenteve në kerkime shkencore.<br>*Vizita në institucion dhe takime me stafin dhe studentet*<br>*Evidenca nr.42. për mbulimin e shpenzimeve për pjesemarrjen e studenteve në konferenca nderkombetare* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të | Në rang institucioni GVJ evidenton forma bashkëpunimi mësimdhënieje me institucione homologe vendase por edhe ndërkombëtare. UT dhe FE ka mobilitete shkëmbimi me universitete të huaja. Mobilitetet e realizuara përfshijnë |

| | |
|---|---|
| mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | kryesisht shkëmbimet mes stafeve si dhe mobilitete studentësh që kanë studiuar për një periudhë afatshkurtër në universitetet e huaja partnere. Vete fakti i ngritjes se ketij programi në kuader të Projektit K-Force tregon për një bashkepunim të frytshem nderkombetar të shoqeruar me mobilitetet e nevojeshme në funksion të rritjes se cilësisë se mesimdhenies. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur rezultojnë 5 studente që kanë realizuar mobilitete pranë partnereve në projekt në fushen e menaxhimit të riskut<br><br>*Evidence 25.1.Marreveshjet nderinstitucionale në kuader të projektit K-Force.*<br><br>*Evidenca nr.27.3. Mareveshjet e mobilitetit të studenteve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi Mikroteze. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e UT ( neni 60; 61 dhe 62 ) dhe rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë. Ky proces është me i detajuar në udhëzuesin e mbrojtjes së diplomës. Në këtë udhëzues jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të mikrotezës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj.<br><br>*Evidenca nr.2.Rregullore e UT*<br><br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes për MSH në MR të FE të UT* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në | Departamenti i Financës, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e Mikrotezës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për |

| | |
|---|---|
| funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | udhëheqësin e punimit. Në Departamentin e Financës përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion.<br>*Takim me stafin dhe studentet në institucion*<br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes për MSH në MR të FE të UT* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjësit të Departamentit dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të Mikrotezës bazohet në katër kritere kryesore:<br>• Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësime gjatë vitit akademik;<br>• Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit;<br>• Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës;<br>• Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti.<br>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programi, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin.<br>*Takim me stafin dhe studentet në institucion*<br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes për MSH në MR të FE të UT* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave. | Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, Departamenti i Financës miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të Mikrotezës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim.<br>*Takim me stafin dhe studentet në institucion*<br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes për MSH në MR të FE të UT* |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e | Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të |

| | |
|---|---|
| matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta.<br>*Takim me stafin dhe studentet në institucion*<br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes për MSH në MR të FE të UT* |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Nga takimi me studentët e Kursit të II-të të këtij programi,u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të mikrotezës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që ngafaza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruara. Në rastin e punimeve të Mikrotezës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zerë një peshë të konsiderueshme.<br>*Takim me stafin dhe studentet në institucion*<br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes për MSH në MR të FE të UT* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura më lart, bën vlerësimin e punimit të Mikrotezës me notë përfundimtare.<br>*Evidence nr.2. Rregullore e UT*<br>*Takim me stafin dhe studentet në institucion*<br>*Evidenca nr.18.Paketa e mikrotezes për MSH në MR të FE të UT* |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve në kete program që i përket vitit akademik 2019-2020.<br>*Evidence nr.16.1. Modeli i diplomes dhe suplementi i saj*<br>*Takim në sekretariNë e institucioniy* |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë | Pas përfundimit të studimeve studenti pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit sapo ai ben edhe kerkesen perkatese. në të njejten kohe ben edhe terheqjen e diplomës dhe suplementin e saj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | *Evidence nr.16.1. Modeli i diplomes dhe suplementi i saj* <br> *Takim në sekretariNë e institucionit* | | | |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacioNë për studentin, nëse kërkohen | Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit. *Takim në sekretariNë e institucionit* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1** <br> **Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Bazuar në rregulloren e brendshme të punes në UT "Per organizimin dhe funksionimin e e administrates se rektoratit të UT-se miratuar në 27.01.2022, neni 10 në nivel instituional është krijuar Drejtoria e Sherbimit të Brendshem (ish Drejtoria e Burimeve Njerëzore) e cila një nder funksionet ka edhe ndjekjen e procedurave të punesimit të personelit akademik dhe joakademik, funksione qe kryen Sektori i Burimeve Njerezore (nje nga tre strukturat e kesaj Drejtorie ) si dhe ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik. <br><br> Në nivel njesie kryesore (FE i UT) funksionon Dega e Burimeve Njerezore dhe Protokollit që mbulon procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe monitorimin e të dhenave nepermjet pasurimit të dosjeve në kohe. Nga takimi |

| | |
|---|---|
| | me personelin e Deges së Burimeve Njerëzore, por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në Fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë. Zyra ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcakton Departamenti përkatës, në vijim priten aplikimet, kontrollohen nga personeli përgjegjës dhe procedohen për intervistim. Dega e BNJ është pjesë e të gjitha hallkave të procesit të rekrutimit dhe ndjekjes së progresit të stafit, duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale.<br><br>Nga shqyrtimi i dy dosjeve të rastësishme nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion. Nga përzgjedhja e dosjeve të stafit të programit gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, gjendet dokumentacioni si: kontrata e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV, etj. Po kështu, në dosjet e stafit akademik, ka edhe të dhëna lidhur me kualifikimet, pjesëmarrjen në veprimtari kërkimore dhe akademike, brenda dhe jashtë vendit.<br><br>*Evidencenr.4. rregulloren e brendshme të punes në UT "Per organizimin dhe funksionimin e e administrates se rektoratit të UT-se*<br><br>*Evidenca nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela nr.1; 2 dhe 4)*<br><br>*Shqyrtim i dosjeve të personelit nga vizita në institucion.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Procedura e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës bazohet në Statutin /rregulloren e UT dhe udhëzimeve perkatese në nivel instituional dhe njesie kryesore dhe ajo baze, ku janë të përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik.<br><br>Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Risku" është përzgjedhur mbi bazën e procedurave parashikuar nga kuadri rregullator i përmendur më lart, në reflektim të ligjit të ri për arsimin e lartë në RSH. Departamenti prezanton nevojat për staf akademik, mbi bazën e ngarkesës mësimore dhe numrin e studentëve të planifikuar, harton kriteret referuese dhe pasi |

| | |
|---|---|
| | miratohen nga Fakulteti, publikohen në faqen e internetit të institucionit dhe mediat audiovizive e të shkruara. Çdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, Fakultetit, Departamentit dhe titullarit të lëndës që do japë mësim.<br><br>*Evidence.nr.4. R regulloren e brendshme të punes në UT "Per organizimin dhe funksionimin e e administrates se rektoratit të UT-se*<br><br>*Evidenca nr.40. Tabelat përmbledhëse të RVB (tabela nr.1; 2 dhe 4)*<br><br>*Shqyrtim i dosjeve të personelit nga vizita në institucion.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Kriteret kryesore të rekrutimit të personelit akademik janë të percaktuara në statutin e UT në një kre me vehte. në raste rekrutimesh në varesi të vendit vakant të shpallur njesia kryesore FE dhe ajo bazë Departamenti i Financës përcakton kriteret specifike për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik. Shpallja e pozicioneve bëhet publike në faqen web të institucionit, dhe njësisë kryesore FE të UT. Aplikimet kalojnë një sistem pikëzimi të ndare në përmbushje te dokumentacionit dhe të intervistes që realizohet me komisionin e ngritur.<br><br>*Evidenca nr.1. Statuti i UT*<br><br>*Evidenca nr.2. Rregullore e UT*<br><br>*Verifikim e një praktike rekrutimi gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit | Kriteret e shpallura për rekrutimet e reja të stafit akademik përcaktojnë kritere të përgjithshme dhe kritere specifike, ku këto të fundit përcaktohen nga Departamenti i Financës që mbulon kete program studimi. Ndër kriteret specifike janë edhe njohja apo zhvillimi i lëndëve për të cilat do rekrutohet, bazuar në programin ku ato zhvillohen, apo preferencat për përfundim studimesh jashtë vendit në fushen perkatese. Rekrutimi kalon neper dy faza, shqyrtimi i dokumentacionit të dosjeve të aplikanteve dhe intervista e kandidateve që kalojnë verifikimin dokumentar. Komisjoni i ngritur harton vendimarrjen e tij ku janë renditur sipas pikeve kandidatet dhe nepermjet titullarit të njësisë kryesore (FE të UT) ja percjelle titullarit të UT i ben miratimin perfundimtar të fituesit,.<br><br>*Evidenca nr.1. Statuti i UT* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Evidenca nr.2. Rregullore e UT*<br>*Evidence nr.49.2. Dokumentacion i procedures se rekrutimit*<br>*Verifikim e një praktike rekrutimi gjate vizites në institucion* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pranë ASCAL-it si dhe nga vizita në ambjentet e FE të UT si njesi kryesore verejme se është një mjedis i pershtatshem për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Investimet e 2-3 viteve të fundit në FE të UT kanë arritur të pajisin zyrat e personelit akademik me infrastrukturen bashkekohore duke siguruar kushtet e nevojshme për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor. Nga verifikimi në institucion u evidentua realizimi i investimeve në përmirësimin e zyrave të personelit drejtues të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Departamentit të Financës ku infrastruktura rrjedhoje e investimit me të fundit të rikonstruksionit të dy godinave është bashkekohore.<br>*Evidentim në ambjentet e FE të UT gjate vizites të GVJ.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Institucioni ka përdorur kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të një pjese të mire stafit, të siguruara më shumë në kuader të projekteve të bashkepunimit me institucione homologe të huaja. Për këtë një pjesë e stafit që është i angazhuar në këtë program ka realizuar këmbime dhe vizita akademike në disa Universitete të huaja në kuadër të programit ERASMUS. Në rang institucional, apo edhe të njësisë kryesore (Fakultetit të Ekonomisë) janë organizuar leksione të hapura me lektorë apo personalitete të fushave që ndihmojnë aftësimin e stafit si dhe aktivitete shkencore të përbashkëta (simpoziumi shkencor i përmendur me lart). Përveç kësaj, janë përdorur forma të tjera për kualifikimin akademik dhe profesional të stafit, dhe veçanërisht në fushën |

| | |
|---|---|
| | e aftësimit pedagogjik dhe në atë të komunikimit nepermjet workshop-eve të realizuara dhe të permendura me lart në kete raport.<br><br>*Evidence nr.23.1 dhe 23.2: Konferenca të organizuara në kuader të projektit K-Forse si dhe nga Departamenti i Finances*<br><br>*Evidence 25.1. Marreveshjet nderinstitucionale në kuader të projektit K-Force.*<br><br>*Evidenca nr.27.1.3. Mareveshjet e mobilitetit të stafit dhe studenteve* |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | UT si institucion aplikues, FE si njesi kryesore dhe Departamenti i Financës si njesi bazë e ketij programi synojnë permiresimin e metodave të mesimdhenies duke perfshire edhe perdorimin e teknologjive të reja dhe kualifikimin e personelit akademik. Gjate dhe pas periudhes se pandemise stafi akademik është trajnuar për perdorimin e metodave të mesimdhenies në distance nepermjet platformave e-learning në Google classroom apo Microsoft Teams. Vete UT ka ngritur "Qendren Virtuale për Zhvillim dhe Trajnim nefunksion të perdorimit të ketyre metodave. Edhe workshop-et e organizuara në FE të UT i kanë sherbyer permiresimit të metodave pedagogjike të mesimdhenies.<br><br>*Evidence nr. 25.5. Trajnime për metodologjinë e mesimdhenies në kuader të projektit K-Force*<br><br>*Evidenca nr.28, Vendim nr.48 dt 25.11,2021 "Për ngritjen Qendres Virtuale të Zhvillimit Profesional në UT*<br><br>*Evidence nr.29. Udhezim i UT për perdorimin e sistemit të mesimit në distance* |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë | Angazhimi i një stafi akademik të kualifikuar dhe organizimi i veprimtarive me fokus permiresimin e metodave të mesimdhenies në nivel institucional dhe të njësisë kryesore të programit (FE i UT) kanë bere të mundur edhe permbushjen me sukses të programit të studimit.<br><br>Departamenti i Financës nga ana tjeter bën përpjekje për të angazhuar si staf akademik edhe personel të ftuar në përputhje me kualifikimet specifike dhe karakteristikat e karakterit ndërdisiplinor të programit të studimit.<br><br>*Evidence nr.16.7.CV e stafit akademik të angazhuar në program*<br><br>*Evidence nr. 25.5. Trajnime për metodologjinë e mesimdhenies në kuader të projektit K-Force* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Referuar dokumentacionit të përcjellë dhe vizitës në institucion për infrastrukturën e UT dhe sidomos të njësisë kryesore( FE) dhe bazë (Departamentit të Finances), GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare, në godinat A dhe B, të përshtatshme për realizimin me sukses të programit. Tashme pas perfundimit të rikonstruksionit të vitit të kaluar krahas ambjenteve mesimore është arritur të kete një akomodim të plote edhe për personelin akdemik që mbulon kete program. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerëzore, Financa, Biblioteka, etj. janë të akomoduar në ambientet e tyre përkatëse, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. *Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Financës kanë ambientet e mjaftueshme në dispozicion për të realizuar me performancë të mirë këtë program. Fakulteti i Ekonomisë ofron ambiente që plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 *"Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre"*, sipas të cilit kërkohen 2.5 $m^2$ / student.<br><br>Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave |

| | |
|---|---|
| | të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit. *Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Në funksion të mësimit dhe punëve shkencore në godinën A dhe B të Fakultetit të Ekonomisë janë në shërbim të studentëve dhe stafit 2 laboratorë ku një prej tyre me 31 kompjutera është ngritur në kuader të projektit K-Foprce në dispozicin të ketij programi dhe që janë të pajisur me teknologjinë bashkëkohore. Këta laboratorë u shërbejnë edhe përgatitjes së punimeve të kursit apo mikrotezës, duke iu përshtatur dhe orarit të mësimit të MSH që është pasdite. *Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Programet e instaluara në kompjuterët e laboratoreve janë bashkëkohore dhe në to janë instaluar edhe programe të lidhura me lëndë karakterizuese të këtij programi siç është Ekonometria, ; Modelimi i riskut në praktike etj. *Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucioNë dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | Me kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, institucioni garanton mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit shkencor të programit. *Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4** |
|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al
Web site:

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në FE të UT, u konstatua se në dispozicion të studentëve vihet edhe Biblioteka e Fakultetit të Ekonomise "Joseph Limprecht", e vendosur në godinën A. Në mjediset e kësaj Biblioteke studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën që ofrohet. Orari dhe shërbimi i ofruar është në funksion të nevojave të studentëve. Mjediset e Bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë. Kjo bibliotekë ofron mundësinë e kërkimit dhe gjetjes së librave online në sallën e leximit në kompjuterin e vendosur përkëtë qellim. Bibloteka e FE operon në bazëtë rregullores perkatese<br>*Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)*<br>*Evidence nr.35. Rregullore e bibliotekes se FE të UT* |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Nga vizita në institucion rezulton se Biblioteka është përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike ( rreth 5280 tituj) në shqip dhe anglisht, që perfshijnë tekste mesimore, libra, revista periodike/buletine të institucioneve punime mikroteze dhe doktorature etj. Sherbimi në biblioteke mbulohet nga 3 punonjes dhe ofrohet në dy ambjentet e veçuara, në vendin e terheqjes se librave dhe sallen e hapur për studim.<br>*Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)*<br>*Evidence nr.35.1. Relacion i biblotekes* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-liNë të fushës së programit të studimit. | Shërbimet aktuale që ofron biblioteka u ofrojnë akses të barabartë përdoruesve potencial (studentëve dhe stafit akademik) dhe pa kosto pasi ata antaresohen pranë saj. Gjithashtu, biblioteka ofron sherbimin online fale marreveshjes se bashkepunimit të UT me Fondacionin Shqiptaro Amerikan pe Zhvillim (AADF) për abonim në biblioteken digjitale JSTOR me akses në mbi 12,000 revista ekonomike, apo rreth 85,000 libra. Biblioteka e Fakultetit të Ekonomise tashme është edhe pjese e programit COBIS që u mundeson perdoruesve të saj akses në baza të dhenash apo informacion të dobishen në fushen e ekonomise për të analizuar dhe perdorur në punime kerkimore shkencore.<br>*Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)* |

| | |
|---|---|
| | *Evidence nr.35.1. Relacion i bibliotekes* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Ekziston një program kompjuterik i përdorur nga biblioteka për gjetjen e titujve të librave. Po ashtu kompjuterët e gjetur në bibliotekë mund të shfrytëzohen nga studentët pa kufizime. Studentet kanë akses të plotëpër të siguruar botime online edhe nëpërmjet disa adresave që janë funksionale për bibliotekën elektronike.<br>*Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)*<br>*Evidence nr.35.1. Relacion i bibliotekes* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Ngritja e ketij programi në kuader të projektit K-Force krijoi mundesinë e sigurimit të teksteve bazëtë shumices se moduleve të programit që perfshin një fond prej 21 titujsh tekste në gjuhen angleze. në evidentuam pasurimin e fondit të bibliotekes gjate 3 viteve të fundit të rreth 300 tituj librash në fushen e ekonomise.<br>*Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)*<br>*Evidence nr.35.1. Relacion i bibliotekes*<br>*Evidence nr.35.5. Lista e librave të rinj të bibliotekes për Departamentin e Finances.* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Biblioteka ka orarin 8.30 me 19.30 duke ofruar shërbime edhe për studentet e këtij programi që e zhvillojnë mësimin pasdite.<br>*Konstatime të GVJ gjate vizites në institucion (FE të UT)*<br>*Evidence nr.35.1. Relacion i bibliotekes* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.5 | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Administrimi i informacionit që lidhet me studentet dhe aktivitetin e tyre mbulohet nga sekretaria mesimore e FE të UT. GVJ gjate vizites realizoi takime dhe monitorime pranë sekretarise mesimore të FE të UT, ku evidentoi administrimin korrekt të informacionit për studentet që në fazen e regjistrimit të tyre deri në procesin e diplomimit. GVJ evidentoi regjistrat themeltar që mbahet për studentet e ketij programi ku beri edhe verifikimet me zgjedhje në 4 raste, dosjet e studenteve në fillim të procesit mesimor, regjistrat e grupeve, procesverbalet e vleresimit, hedhjen e tyre në regjistrin themeltar etj. Sekretaria mesimore po hidhte në sistem të gjithe informacionin lidhur me aktivitetin e studenteve që nga viti 2017 e në vazhdim, vit kur edhe sistemi i menaxhimit të informacionit nuk është funksional. Kjo perbente dhe një punë sa voluminoze aq intensive nga kjo hallke e administrimit nisur edhe nga fakti që FE i UT ka dhe numrin me të madh të studenteve në Shqiperi.<br><br>Një zhvillim pozitiv se fundmi është edhe perfitimi i dy sherbimeve nga studentet nepermjet platformes qeveritare e-Albania ku studentet kanë mundesi të marrin dy dokumente të rendesishme; Listen e notave dhe Vertetimin e diplomes. Institucioni nëpërmjet faqes së tij zyrtare pasqyron informacionin me karakter akademik, administrativ kulturor e social.<br><br>Informacioni shkencor realizohet edhe nëpërmjet revistës shkencore.<br><br>*Vizita e GVJ në ambjentet e sekretarise mesimore të FE të UT*<br><br>*Evidence nr.36.1/2. Manual sistemi e-student për pedagoget/studentet* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe administrativ të këtij programi bëhet nga Departamenti i Financës. Me këtë rol merret kryesisht përgjegjësi i Departamentit dhe drejtuesit e grupeve mësimore dhe kërkimore. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në Dekanat dhe Degen e Burimeve Njerezore të FE të UT që ben perditesimin e dokumentacionit.<br><br>*Evidence nr.4.Rregullore e brendshme e UT; "Per organizimin dhe funksionimin e administrates se Rektorit.*<br><br>*Takime pranë Deges se Burimeve Njerezore në FE të UT.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacioNë e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Personeli dhe studentet pas kerkeses se tyre kanë akses informacioni që zoterohet nga Sekretaria mesimore. Se fundmi është ngritur dhe funksionon Sistemi i Menaxhimit të Informacionit (SIM) që u jem mundesi aksesi perdoruesve (pedagoge, student Dege e IT etj). *Evidence 36. Perdorues të SMI-print screen* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Institucioni, FE i UT sigurojnë informacionin e nevojshem edhe nepermjet platformave e-learning në Google classroom dhe Microsoft Teams. Rrjetet sociale të njohura tashmë në tregun e informacionit janë mjete të tjera në funksion të marrjes dhe dhënies së informacionit që mbështetet me infrastrukturën e duhur. Sistemet e përmendura me lart mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit mes personelit akademik dhe ndihmës me studentët. *Evidence 32.3. Platforma e-learning Microsoft Teams* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Sistemi i Menaxhimit të Informacioni i bere aktiv gjate vitit të kaluar, mundeson monitorimin dhe dhenien e informacionit të veprimtarise administrative dhe akademike të institucionit<br><br>*Konstatim gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | Nga konstatimi i GVJ, faqja e internetit e institucionit dhe e FE të UT përfshin informacionin lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme që kanë të bejnë me datat e provimeve, orarin e studimeve mundesi punesimesh etj. Përveç kësaj, UT është shumë aktive edhe në rrjetet sociale, në të cilat ka gjithnjë informacion lidhur me programin si dhe me aktivitete të tjera që organizon Universiteti dhe Fakulteti i Ekonomisë. Një pjesë e këtyre njoftimeve janë të emetuara në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht. *Konstatim gjate vizites në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Web site:

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ, referuar dokumentacionit të përcjellë, konstaton se UT dhe FE i UT në fillimin e ketij programi në kuader edhe të projektit K-Force ka hartuar planin financiar ku elementi kyç është llogaritja e kostos për student bazuar në elementet perberes të shpenzimeve dhe të ardhurave që do të realizohen. Kete e shohim në hartimin e planit financiar të ketij programi. *Evidence nr.16.9.Plani financiar i programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | Si produkt i projektit K-Force FE i UT në planin financiar të hartuar për kete program ka zbatuar marreveshjen e projektit ku vetem për vitin e pare të studimit 2018-2019 studentet e regjistruar nuk kanë paguar tarife. Me pas është paguar tarifa e miratuar nga institucioni. në vitin e pare të studimit një pjese e mesimdhenies është perballuar edhe nga projekti ku lektore nga universitete të huaja pjesemarres në projekt kanë zhvilluar cikle leksionesh. në vijim të ardhurat e programit nga tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, shërbime të ndryshme të institucioni, burime të tjera, ku përqindjen më të madhe e zënë dy kategoritë e para janë evidentuar në planin financiar. Gjithashtu shpenzimet e planifikuara sipas zërave standard janë evidentuar në këtë plan financiar ku janë parashikuar orët e mësimdhënies dhe elementët e tjerë të kostos së programit. Të gjitha kategoritë e kriterit janë të përfshira në këtë plan.<br>*Evidence nr.16.9.Plani financiar i programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera | Procesi i auditimit realizohet nga njesia e posaçme që në nivel institucioni është Drejtoria e Auditimit të Brendshem dhe që tashme varet drejtperdrejt nga Bordi i Administrimit. Kjo njesi realizon auditime të pervitshme me fokus menaxhimin e fondeve në dispozicion të institucionit ku janë evidentuar ecuritë dhe problemet financiare. Në bazë të metodologjive të percaktuar UT harton planin Buxhetor afatmesem i cili miratohet në Senatin Akademik dhe sherben si bazë per projekt Buxhetet vjetore. Ky projekt Buxhet bazohet në propozimet e |

| | |
|---|---|
| financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | cdo njesie kryesore, në rastin konkret FE i UT. Vetë projekt buxheti i FE bazohet në të dhenat ekonomiko financiar të njesive bazëqe janë 6 Departamentet perkatese. Pra zbatohet parimi i hallkes bazë në planifikim<br>*Evidence 37.Buxheti i miratuar për vitin 2019; 2020; 2021*<br>*Evedence 37.1.Program Auditimi*<br>*Evidence nr.37.2.Raport Auditimi* |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Institucioni harton raportin financiar të vitit perkates dhe e dergon për miratim në Senatin Akademik bazuar në Standartet Kombetare dhe nderkombetare të kontabilitetit dhe raportimit financiar. Edhe vete njesia kryesore e programit FE i UT dokumenton dhe ruan raportin financiar në Degen e Financës dhe të Buxhetit. Në raportet financiare të tre viteve të fundit evidentohen gjithe burimet financiare të siguruara ku pjesa me e madhe i perket tarifave të studimit si dhe elementet e shpenzimeve në teresi dhe me elemente të natyrave të veçanta (shpenzime korrente dhe investime). Pra, raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare. Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike Zyra e Financës pranë UT-së bën relacion mbi projekt buxhetin me qëllim që të kontrollojë mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së studimeve si dhe të identifikojë burimet e mundshme të gjenerimit të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.<br>*Evidence 37.Buxheti i miratuar për vitin 2019; 2020; 2021*<br>*Evidence nr.40 . Përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela nr 18)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen | UT si institucion si dhe FE i UT si njesia kryesore e ketij programi kanë qendrueshmeri financiare duke mbuluar shpenzimet me të ardhurat, rrjedhoje kjo kryesisht e numrit të madh të studenteve dhe fitimit të projekteve të ndryshme me institucione homologe vendase dhe të huaja.<br>*Evidenca nr.37.Vertetim mbi qendrueshmerinë finaciare të UT* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | [illegible] | Përmbushen pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminnë programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Institucioni krahas zbatimit të akteve ligjore në fuqi, ka përcaktuar politikat dhe procedurat përkatëse lidhur me procesin e hyrjes së studentëve, realizimit të programit dhe diplomimit të tyre. Në funksion të kësaj, krahas statutit, janë edhe rregullorja e institucionit, rregullorja e Fakultetit të Ekonomisë dhe Rregullorja e vetë programit të studimit. Në nene të veçanta të këtyre akteve nënligjore dhe rregullative janë të përcaktuara të gjitha procedurat që shoqërojnë ecurinë e studentit në hyrje, zhvillim dhe përfundim të programit. Gjithashtu, institucioni ka vendime të veçanta mbi procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit të programeve në UT si dhe kriteret mbi të cilat bazohet ky proces. Vendimarrja realizohet në funksion të organit perkates që e ka kete të drejte bazuar edhe në statutin e UT dhe akteve të tjera ligjore dhe rregullative.<br><br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br><br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br><br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për | GVJ konstaton nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat e ndjekura nga hyrja në |

| | |
|---|---|
| studentë dhe studentët e programit të studimit. | dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit.<br><br>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (qe nga Rektorat, Senat Akademik , Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Financës, etj) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UT apo FE<br><br>*Evidence nr. 2 .Rregullore e UT*<br><br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes se studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UT, të Fakultetit të Ekonomisë si dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi nuk na rezultoi që të kishte pasur largime apo transferime studentësh. Në aktet rregullatore të njësisë kryesore dhe njësisë bazë janë të përcaktuara qartë kriteret e pranimit dhe transferimit të studentëve.<br><br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br><br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br><br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR*<br><br>*Evidence nr.16.8.Propozim për hapjen e programit MSH në MR* |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | Bazuar në kuadrin rregullator të permendur me lart, GVJ konstaton se janë të percaktuar qarte kriteret e pergjitheshme për perzgjedhjen e kandidateve fitues për tu regjistruar në kete program. Gjithashtu me propozim të Departamentit të Financës që mbulon kete program miratohen edhe kriteret e veçanta të kandidateve aplikues duke e bere prosesin konkurues por njekohesisht edhe të rrise mundesinë e prurjeve cilesore në kete program. Vendimarrja për fituesit merret nga organet drejtuese në bazëtë relacionit të komisionit të ngritur për kete qellim.<br><br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br><br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br><br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | U verifikua që informacioni i mësipërm behet publik në faqen zyrtare të UT dhe FE,përfshirë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. Edhe guida e studentit e përgatitur paraprakisht është një mjet shtesë në arritjen e këtij qëllimi.<br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br>*Evidence nr.13.Broshura e Departamentit të Finances*<br>*Evidence nr.40.1. Kriteret e pranimit për vitin akademik 2021* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Bazuar në dokumentacionin e aplikimit pran ASCAL-it të institucionit si dhe nga takimi me studentet dhe stafin akademik të programit gjate vizites në instituion konkludojme që studentët e regjistruar në këtë program marrin informacion lidhur me ecurinë apo progresin akademik të tyre permes disa kanaleve të komunikimit.<br>Informacionin e pergjitheshem studentet e marrin nepermjet faqes se internetit të UT dhe sidomos të FE të UT në të cilat perditesohen informacionet dhe dalin njoftimet me të fundi. Po në kete rruge komunikimi merret informacion për orarin mesimimor grafikun e provimeve datat e eventeve të tjera etj. Informacion me specifik të modulit të programit studentet e marrin në fillim të zhvillimit të lendes nepermjet titullarit perkates në seminarin udhezues që zhvillohet javen e pare të mesimit. Ketu njihen me syllabusin e modulit, literaturen bazëdhe ndihese, format e vleresimit etj. një kanal tjeter komunikimi lidhur me mesimdhenien janë edhe perdorimi i adresave elektronike të pedagogeve dhe studenteve të cilat mund të jenë individuale por edhe adresa të grupeve mesimore (ky program ka një grup studentesh) ku informohen lidhur me vleresimet, njoftimet për reklamim, etj. Gjithashtu, studentët marrin nformacionedhe në faqen zyrtare të pedagogut përkatës. Studentet marrin informacion të perditesuar apo edhe aktual |

| | |
|---|---|
| | edhe nepermjet sekretarise mesimore të ciles ata i drejtohen për informacionin e deshiruar. Departamenti i Financës ka të botuar edhe broshuren e departamentit si një mundesi shtese për informim.<br>*Evidence nr.13.Broshura e Departamentit të Financës.*<br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR*<br>*Takim me stafin akademik dhe studentet gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e ketij programi që në momentin e regjistrimit studentet informohen mbi kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mepareshme. Për njohje të krediteve lidhur me transferimet, Fakulteti i Ekonomisë ngre një Komision të posaçëm që vlerëson dhe njeh këto kredite. në FE të UT ka dhe një udhezues për kete proces e miratuar nga ZV.Dekani që mbulon procesin mesimor. Një rast konkret (me zgjedhje) i kësaj procedure u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion lidhur me njohjen e provimit të studentet të dhenë në universitete të huaja në kuader të programit ERASMUS.<br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR*<br>*Vizita në sekretarin mesimore për evidentimin e praktikes se njohjes se modulit.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Forma kryesore e informimit të studentëve lidhur me vlerësimin e dijeve janë programi informatik nepermjet platformave elektronike e -learnig të permendura me lart, siti personal i pedagogut të lëndës, rrjeti i email-ave domen e UT dhe FE të UT, komunikimi i drejtpërdrejtë në takime studentë-pedagogë, sidomos në periudhën pas provimit kur ende rezultati nuk është konfirmuar përfundimisht<br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit të studimit MSH në MR*<br>*Takim me stafin akademik dhe studentet gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje | Nga takimi me studentët e këtij programi të kursit të dyte u konfirmua se ata ishin njohur me kriteret dhe procedurat e |

| | |
|---|---|
| me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të mikrotezës që në fillim të vitit të dytë si nëpërmjet udhëzuesit të institucionit, ashtu edhe nga pedagogët përkatës dhe njëkohësish të dhëheqësit të punimeve të tyre. Gjithashtu,një informacion në këtë drejtim studentët marrin edhe nga faqja e internetit të UT dhe FE të UT.<br><br>*Takim me stafin akademik dhe studentet gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Që gjatë procesit të aplikimit dhe në vazhdimësi, studentët marrin informacion në institucion nëpërmjet takimeve pranë zyrës së informacionit në sekretari, udhëzuesit të studentëve (guides perkatese të studentit), webit të institucionit, etj.<br><br>Nga takimi me stafin akademik u evidentua roli i Departamentit të Financës në informimin e kontigjenteve potenciale për tu regjistruar në kete program që janë studentet në diplomim të programit Bachelor në Finance. Nga ana tjeter studentet kandidate që duan të ndjekin studimet në programin MSH në MR marrin informacion të dobishem edhe pranë Zyres se Karrieres që siguron keshillimin e tyre. në kuader të projektit K-Force janë shfrytesuar për informim të kandidateve potencjal për të ndjekur kete program edhe takimet informuese në institucione të ndryshme që operojnë në tregun shqiptar të punes.<br><br>*Takim me stafin akademik, studentet dhe Zyren e Karrieres të FE të UT gjate vizites në institucion*<br><br>*Evidence nr.38. Guida e studentit të FE të UT* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, | Universiteti aplikon forma të ndryshme të informimit të studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Këtu përfshihen krahas takimeve informuese në fazën e aplikimit (zyra e karrierës dhe shërbimit të studentëve, |

| | |
|---|---|
| organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | sekretaria mesimore etj) edhe mundësia për tu njohur mbi aspekte të ndryshme të programit. Kjo arrihet nëpërmjet shpalljes së programit, strukturës së tij dhe syllabusve, të cilat japin informacion të hollësishëm si dhe takimit të pedagogut të lëndës në prezantimin e parë që ai bën në fillim të semestrit.<br>*Takim me stafin akademik, studentet dhe Zyren e Karrieres të FE të UT gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Guida e studentit, informacioni në vend dhe informimi paraprak në webin e UT dhe FE të UT i shërbejnë periudhës para regjistrimit të studentëve. Pas kësaj studentët marrin informacion të plotë dhe periodik dhe të hollësishëm mbi përmbajtjen e programit, detyrimet që kanë të bëjnë me frekuentimin, vlerësimin gjatë vitit, në fund, etj.<br>*Takim me stafin akademik, studentet dhe Zyren e Karrieres të FE të UT gjate vizites në institucion*<br>*Evidence nr.38. Guida e studentit të FE të UT* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion në takimin me zyrën e këshillimit të studentëve dhe Alumni-t, ata merrnin informacion mbi mundësinë e punësimit pas diplomimit të tyre. Si bazë shërben edhe studimi i tregut të realizuar në institucion.<br>Informacioni i nevojshëm për studentet përditësohet dhe ata e kanë mundësinë ta marrin nëpërmjet të gjitha formave të përmendura më lart.<br>*Takim me stafin akademik, studentet dhe Zyren e Karrieres të FE të UT gjate vizites në institucion*<br>*Evidence nr.16.8.Propozimi për hapjen e programit të studimit MSH në MR* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Sudentet kanë akses të plote në marrjen e informacionit permes gjithe kanaleve të komunikimit elektronik të permendura me lart, si dhe nepermjet kontakteve me stafin akademik që mbulon kete program, drejtuesit e njësisë kryesore/baze, Zyren e Karrieres dhe sekretarinë mesimore.<br>*Evidence nr.16.3. Rregullore e programit MSH në MR*<br>*Takim me stafin akademik, studentet dhe Zyren e Karrieres të FE të UT gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të | Sistemi i informacionit me të gjitha format e analizuara me lart është i arritshëm edhe nga studentët në distancë. Edhe nga |

| | |
|---|---|
| brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | takimi me studentët e programit, opinioni i tyre mbi lehtësinë e marrjes së informacionit ishte pozitiv.<br>*Takim me stafin akademik, studentet dhe Zyren e Karrieres të FE të UT gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 6.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve | Nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit arrihet të administrohet informacioni dhe dokumentacioni mbi aktivitetin mësimor të studentëve. GVJ evidentoi perdorimin e dokumentacionit perkates të mesimdhenies duke filluar që nga regjistri e pedagogut të lendes, lista e grupeve mesimore, regjistri tip e pedagogut, procesverbalet perkatese të vleresimit, paketa e praktikes profesionale etj.<br>*Takim me stafin akademik, studentet, sekretariNë mesimore dhe Zyren e Karrieres të FE të UT gjate vizites në institucion* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacion dhe vizitën në institucion në takimin në sekretarinë mësimore, u evidentua mbajtja e statistikave vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në kete program studimi. Në këtë program kontigjenti i pare i diplomuar ka qenë në vitin akademik 2019-2020 i 18 studenteve dhe në vitin 2020-2021 janë diplomuar 27 studente.<br>*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela nr 23 )*<br>*Takim me, sekretarinë mesimore të FE të UT gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe | Sipas dokumentacionit të përcjellë dhe vizitës në institucion,u evidentua mbajtja e statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në program, largimet para përfundimit etj. Kjo u evidentua dhe konfirmua edhe gjatë |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
www.ascal.al
Web site:
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. | vizitës në sekretarinë mësimore, në regjistrin themeltartë studentëve të këtij programi.<br><br>Mbështetur në (*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB tabela nr 21)* dhe vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vite akademike është:<br><br>2019-2020 32 studentë;<br>2020-2021 32 studentë;<br>2021-2022 27 studentë;<br><br>*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela nr 23 )*<br><br>*Takim me, sekretarinë mesimore të FE të UT gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Gjatë vizitës në institucion në sekretarinë mësimore, u evidentua gjithashtu mbajtja e statistikave vjetore për ecurinë mësimore të studentëve të regjistruar në program deri në stadin aktual për këtë program studimi. Në regjistrin mësimor të studenteve ishin vendosur të gjitha vlerësimet e tyre, përfshirë edhe praktikën. Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit ku edhe ruhet konfidencialiteti. U evidentuan dy praktika studentësh të këtij programi lidhur me informacionin statistikor të procesit mësimor dhe progresit të tyre deri në fazën aktuale.<br><br>*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela nr 23 )*<br><br>*Takim me, sekretarinë mesimore të FE të UT gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Gjate vizites pranë sekretarisë mesimore të FE të UT në administrimin e informacionit në sistemin informatic, të dhenat për ecurinë akademike të studenteve perpudhen me dokumentacionin perkates si procesverbale provimesh, riprovimesh regjistrin themeltar etj. Keto të dhena kanë krijuar database e plote të informacionit e cila menaxhohet nepermjet sistemit të brendshem të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin si dhe informimin e shpejte të studentit në rast të kerkesave të tij për informacion.<br><br>*Evidenca nr.4.1. Rregullore për funksionimin e sistemit informatic në UT.* |

| | |
|---|---|
| | *Evidence nr.36.2. Manuali i sistemit e-student për studentet*<br>*Takim me, sekretariNë mesimore të FE të UT gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | Institucioni dhe njësia kryesore/bazë hartojnë raportet vjetore të analizës mësimore shkencore të hallkave përkatëse, ku në to gjejnë pasqyrim trajtimet e procesit mësimor, cilësia e hyrjeve dhe daljeve të studentëve si dhe detyrat në të ardhmen.<br>*Evidence nr.20.3.Analiza vjetore e Departamentit të Financës për vitin 2021* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | UT, në zbatim të ligjit 80/2015 dhe të statutit dhe rregullores të tij, u garanton studentëve përfaqësim në proceset vendimmarrëse dhe këshilluese në nivel instititucioni si në Senatin Akademik, Keshillin e Etikes, Komisioni i Kurrikules, NJSBC, apo edhe në nivel të FE të UT si në NJSBC, Grupet e Vetëvlerësimit në kuadër të proceseve të akreditimit të programeve, etj. në bazë të rregullores se UT operon dhe Keshilli i studenteve që perfaqeson dhe mbron interesat e studenteve. U evidentua pjesëmarrja e studentëve në këto organe vendimmarrëse dhe pjesëmarrja e tyre në takimet që ato zhvillonin nëpërmjet vendimeve përkatëse të ngritjes së këtyre strukturave apo gjate operimit të tyre.<br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT* |

| | |
|---|---|
| | *Evidence nr.39. Rregullore për zgjedhjen e Keshillave të studenteve në UT.*<br>*Takime me student gjate vizites në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Nga shqyrtimi i dosjes se aplikimit të institucionit pranë ASCAL-it si dhe nga takimi me studentet në viziten e GVJ në institucion evidentohet roli aktiv i studentëve apo i perfaqesuesve të tyre në organet vendimarrese. Gjithashtu, një rol të rendesishem kanë studentet nepermjet vleresimit periodik që ata bejnë për nivelin e mesimdhenies gje e cila realizohet si nepermjet anketimit anonim ashtu edhe nepermjet diskutimeve me titullaret e lendeve perkatese të programit.<br>*Takime me student gjate vizites në institucion*<br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br>*Evidence nr.6. Rregullore për sigurimin e cilesise* |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Nga shqyrtimi i programit të studimit është mbajtur parasysh ngarkesa akademike e studentëve, duke u bazuar në kriteret e ngarkesës mësimore bazuar në kredite. Kjo u konfirmua edhe në takimin me stafin akademik që mbulon programin, si dhe me studentët. Gjithashtu garantohet baza rregullative dhe procedurale lidhur me njohjen e studimeve të plota apo të pjeseshme të mepareshme.<br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br>*Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR* |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Hartimi i programit të studimit të ciklit të dytë MSH në " Menaxhim Risku" është bërë në përputhje me bazën ligjore në fuqi për hapjen e programeve të studimit dhe udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Nga takimi me studentet konfirmohet diskutimi që realizojnë titullaret e lendes me studentet ku marrin në konsiderate sugjerimet e tyre në permiresimin e programit. në rastet e evidentuara janë marre parasysh shtimi i oreve të aplikimit të modeleve ekonometrike me raste studimore nga praktika.<br>*Takime me student gjate vizites në institucion*<br>*Evidence nr.1. Statuti i UT*<br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT* |

| | |
|---|---|
| | *Evidence nr.6. Rregullore për sigurimin e cilesise* |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës | Nga takimi me studentet nuk u evidentua ndonjë reklamim i tyre lidhur me vlerësimin e dijeve nga pedagoget, por ata shprehën opinion pozitiv për vlerësimet e dijeve të tyre. Nga ana tjeter, institucioni disponon kuadrin rregullativ dhe udhezimet perkatese në funksion të ketij qellimi.<br>*Evidence nr.2 .Rregullore e UT*<br>*Evidence nr.16.3 .Rregullore e programit të studimit MSH në MR* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.** | |
|---|---|
| **Kriterct** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | Bazuar në dokumentacionin e aplikimit dhe vizitën në Institucion, evidentohet fakti i angazhimit aktiv të stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore. Kjo duke analizuar, krahas raporteve vjetore të punës kërkimore shkencore në njësinë kryesor/bazë, edhe formularin e performancës akademike të stafit që mban njësia kryesore/bazë, NJSBC dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Bazuar në raportin e kërkimit shkencor të institucionit, si dhe tabelat përmbledhëse bashkangjitur RVB, rezulton se gjatë 3 viteve të fundit nga ana e stafit akademik të programit janë realizuar 13 botime shkencore, 6 projekte të fituara dhe janë realizuar 135 aktivitete shkencore. Numri i studentëve të përfshirë në këto aktivitete në bashkepunim me pedagoget perkates është 20 në rang njesie baze.<br>*Evidence nr.19.dhe 19.1.Rapor vjetor i veprimtarise se FE të UT dhe i Departamentit të Financës 2020-2021*<br>*Evidence nr.40.Përmbledhëse e tabelave të RVB, (tabela 19- dhe 20* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | Bazuar në dokumentacion e aplikimit si dhe viziten në institucion në takimin me zyrën e projekteve, u evidentua se UT si dhe njesia kryesore/baze kanë qenë aktive në lidhjen e marrëveshjeve me institucione homologe të huaja duke rritur nivelin e nderkombetarizimit të veprimtarise kerkimore shkencore në nivel institucional apo dhe të FE të UT.<br>*Evidence nr.19.dhe 19.1.Rapor vjetor i veprimtarise se FE të UT dhe i Departamentit të Financës 2020-2021*<br>*Evidence nr.21.Lista e marreveshjeve të bashkepunimit në nivel FE të UT* |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore. | Bazuar në dokumentacionn e aplikimit dhe vizitës në Institucion, personeli akademik inkurajon studentët të angazhohen, të shkruajnë dhe botojnë studime punimi shkencore. Kjo përgjithësisht është realizuar në bashkëpunim pedagog udhëheqës- student gjatë përgatitjeve të punimeve të mikrotezave. Gjithashtu, u evidentuan raste të përdorimit të mobiliteteve të studentëve pranë universiteteve të huaja që janë shfrytëzuar në përgatitje të punimeve të mikrotezave.<br>Stafi akademik inkurajohet për të realizuar botime në revista shkencore të vendit dhe të huaja një drejtim i rendesishem i perfshirjes se studenteve në punime e synime shkencore është dhe organizimi i konferencave shkencore në rang njesie kryesore dhe bazësi dhe konferencat studentore ku keta të fundit janë aktiv në pergatitje të referimeve perkatese të cilat tashme janë bere pjese e veprimtarise se FE të UT dhe Departamentit të Financës që mbulon kete program. Kjo është një praktike shume frytdhenese në funksion të angazhimit të studenteve të ketij programi në kerkime shkencore. Bazuar në raportin e kërkimit shkencor dhe tabelat përmbledhëse të RVB, studentët janë përfshirë në bashkëpunim me stafin në punime shkencore, ku janë evidentuar 20 studentë.<br>*Evidence nr.23.2.Konference të organizuara nga Departamenti i Finances*<br>*Evidence nr.23.4. Konferenca studentore të FE të UT*<br>*Evidence nr.23.4.1.Botime të studenteve në konferenca kombetare dhe nderkombetare* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të | Institucioni dhe njesia kryesore/baze inkurajon dhe mbeshtet publikimin në revista shkencore të stafit akademik dhe studenteve. Megjithese në buxhetin e institucionit për vitet 2020 dhe 2021 janë planifikuar fonde për kerkimin shkencor (perkatesisht 33 milion ALL dhe 21 milion ALL ) ato |

| | |
|---|---|
| personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | perfshihen edhe disa zera që nuk kanë natyren e shpenzimit për mbeshtetjen financiare të botimeve shkencore të stafit akademik. Vetem në Korrik 2021 Senati i UT ka miratuar programin e grantit për prezantimet e një punimi, kerkimi në konferenca nderkombetare.<br><br>Mbeshteta e studenteve të ketij program në kete drejtim është materjalizuar në financimin e tyre në kuader të projektit K-Force për pjesemarrje në konferenca nderkombetare. *Megjithe progresin e viteve të fundit në kete drejtim, GVJ sugjeron që institucioni duhet të hartoje procedura me të plota në funksion të këtij procesi.*<br><br>*Evidence nr.23. Vendim Senati nr.28 date 22.07.2021. "Per programin e grantit për prezantimin e një punimi, kerkimi në konferenca nderkombetare.*<br><br>*Evidence nr.23.4.1.Botime të studenteve në konferenca kombetare dhe nderkombetare*<br><br>*Evidence nr.37. Buxheti i miratuar për vitet 2019;2020 dhe 2021*<br><br>*Evidence nr.42. për mbulimin e shpenzimeve për pjesemarrjen e studenteve në konferenca nderkombetare* |
| **Kriteri 5.** Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. | Motivimi dhe mbeshtetja nga institucioni i studenteve në angazhimin e tyre në studime inovative realizohet si nepermjet marreveshjeve në kuader të programeve ERASMUS + ashtu edhe në mareveshjet institucionale që FE i UT dhe Departamenti i Financës ka me institucione dhe organizata të biznesit apo institute të ndryshme. në kuader të ketij bashkepunimi për kete program studimi ka 12 marreveshje bashkepunimi me organizata dhe institucione breda vendit<br><br>*Evidence nr.19.1. Raporti vjetor i kerkimit shkencor*<br><br>*Evidence nr. 27.2. Lista e mobiliteteve të studenteve*<br><br>*Evidence nr.40. Tabela përmbledhëse e RVB (tabela nr5)* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | U evidentua nga takimi me studentët e programit se asistenca kryesore e stafit akademik në këtë drejtim realizohet gjatë përgatitjeve të detyrave të kursit apo punimeve të diplomës së studentëve, duke shfrytëzuar infrastrukturën që ofron institucioni.<br><br>*Takimi me stafin akademik dhe studente*<br><br>*Evidence nr.16.3.Rregullore e programit të studimit MSH në MR* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.7** <br> **Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. | Bazuar në marreveshjet e bashkepunimit që FEi UT ka me një numer institucionesh dhe organizatash konsiderohen si një mundesi shtese për të rritur kapacitete shkencore dhe profesionale të stafit dhe studenteve. Janë disa nga bankat tregtare dhe institucione sigurimesh me të cilat ka marreveshje bashkepunimi. Po ashtu janë pale në marreveshje bashkepunimi Bursa e Tiranes dhe INST-i si institucione me të cilat kerijohet premisa e bashkepunimit shkencor duke implementuar metoda bashkekohore të analizes dhe menaxhimit të riskut. <br><br> *Evidence nr.19.dhe 19.1.Rapor vjetor i veprimtarise se FE të UT dhe i Departamentit të Financës 2020-2021* <br><br> *Evidence nr.40. Tabelat përmbledhëse të RVB (tabela nr,5)* |
| **Kriteri 2.** Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | Bazuar në planin mësimor të programit dhe syllabuseve të lëndëve që përfshin ky program, evidentohet niveli teorik shkencor i tij. Në këtë këndvështrim, në shumicën e lëndëve karakterizuese të programit, dominon përdorimi i metodave bashkëkohore të kërkimit dhe i programeve që ndihmojnë në përdorimin e këtyre metodave. Nga ana tjetër, shqyrtimi i CV të personelit akademik tregon për nivelin e duhur shkencor që ata kanë si premisë e përcjelljes së njohurive të thelluara që ata japin në këtë program. Mbi këtë bazë programi plotëson kriterin për ti shërbyer programit të ciklit të tretë të studimit. <br><br> *Evidence nr.16.4.Plani mesimor i programit MSH në MR.* <br><br> *Evidence nr.16.6. Programet mesimore të lendeve 2021-2022* |
| **Kriteri 3.** Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj. | Nga takimi me stafin, u evidentuan raste të përfshirjes së stafit të ri në projektet kërkimore ku UT është pjesëmarrës. Në grupet pjesëmarrëse në këto projekte ka përfshirje të stafit me eksperiencë të gjatë me ata me eksperiencë relativisht të paket. Gjate 3 viteve të fundit në kuader të njësisë kryesore |

| | |
|---|---|
| | janë realizuar 6 aplikime për projekte nga të cilet 5 kanë qeNë të sukseseshme dhe janë në fazen e zbatimit.<br><br>*Evidence nr.26 dhe 26.1. Thirrja për projekte në kuader të programit UT-kerkim experience, inovacion; dhe aplikime dhe projekte në zbatim në kuader të thirrjeve nderkombetare* |
| **Kriteri 4.** Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | Siç edhe e kemi theksuar me lart gjate vitit të pare të zhvillimit të programit disa nga modulet mbuluar nga lektore të huaj ( në kuader të projektit K-Force). Nga ana tjeter mundesia e mobiliteteve të realizuara nga stafi akademik i programit në kuader të ERASMUs + u kanë dhenë mundesinë ketyre të fundit të marrin eksperjence dhe të aplikojnë metodat shkencore në kerkim.<br><br>*Evidence nr.24.dhe 24.1. leksione të hapura dhe leksione me lektore të huaj në programin MSH në MR*<br><br>*Evidence nr.40. përmbledhëse e tabelave të RVB (tabela nr19, 20,22)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetitin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. | Institucioni promovon dhe nxit aplikimet e studenteve për mobilitetet në kuader të projekteve që janë në zbatim duke informuar si nepermjet shpalljeve të aplikimeve në linkun perkates të marreveshjeve në kuader të ERASMUS + ashtu edhe nepermjet thirrjeve në web-in e institucionit. Nga ana tjeter, njesia kryesore/baze e programit informon studentet për aplikime të ketyre mobiliteteve.<br><br>*Evidenca 27.2. Lista e mobiliteteve të studenteve*<br><br>*Evidence nr.40.Tabele përmbledhëse e RVB.*<br><br>*Evidence nr.44. Praktike për njohjen dhe transferimin e krediteve të studimit.* |
| **Kriteri 6.** Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | FE i UT si dhe Departamenti i Financës në kuader të marrevesheve të bashkepunimit me IAL të huaja kanë organizuar leksione të hapura me studentet e programit si dhe workshome me studiues të huaj. në kete program një pjese e lendeve të zhvilluara në vitin e pare të programit 92018-2019) janë zhvilluar nga lektore të huaj.<br><br>*Evidence nr.22. Workshope*<br><br>*Evidence 24. leksione të hapura*<br><br>*Evidence 24.1. dhe 24.2.LeksioNë me lektore të huaj në programin MSH në MR* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.8 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
